

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Eri MURATI
Zv/kryeredaktor: Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIV - Nr. 7486 E hënë 2 Prill 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion **Ditës**

“Jam ushtari i rrugës, por me mikrofon në dorë”, është një nga vargjet më të njohura të këngës “Ushitari i rrugës”, e grupit në të cilin bënte pjesë edhe Arbër... Vijnë në faqen 20

Nga JULIAN ZYLA

Ritmi i Rrugës së Kombit



Opinion **Ditës**

Nga SHABAN MURATI

Thellim i çarjes strategjike në Ballkanin Perëndimor

Katër shtete të Ballkanit Perëndimor: Shqipëria, Mali i Zi, Kroacia dhe Maqedonia, iu bashkuan qëndrimit të shumicës së shteteve të BE dhe të NATO-s për të... Vijnë në faqen 21



Flet drejtoresha e INAS: Kush janë të favorizuarit

'300 shqiptarë do të fitojnë bashkim familjar në Itali, kriteret dhe dokumentet që nevojiten'

Beskida Aliaj: 5 kategoritë që mund të aplikojnë për qëndrim në këtë shtet

Nga VOLTIZA DURO
Deri në mars të 2019-ës, plot 300 shqiptarë do të kenë mundësinë të bëhen pjesë e projektit FORMA, për të lehtësuar kështu rrugën e tyre drejt bashkimit familjar në Itali. Përfitues të këtij projekti janë fëmijët, bashkëshortët dhe prindërit e shtetasve të huaj...

Në faqen 12

RRUGA E KOMBIT, RAMA: NUK TERHIQEMI NGA TAKSA. TE MARTEN GJYQI

23 KUKSIANET SILLEN NE TIRANE, BASHA: LIROJINI

Arrestimet gjatë mesnatës, banorët: Policët na terrorizuan. Protesta zhvendoset në kryeqytet, kërkohet lirimi i tyre. Detajet e operacionit



(Në foto) Protestues duke djegur sportelet e pagesës së takses në rrugën e Kombit. Kryeministri Rama. Protesta e djeshme para komisarariatit të policisë së Kukësit

FLET SEKRETARI I PD
Bozdo: Qëndrimi në frëngji pasi ke "qit pushkë", nuk sjell bashkim. Zgjedhjet afër
Në faqen 6-7

EMRAT E TE ARRESTUARVE
Superaksion në Vlorë, 6 trafikantë bien në pranga, sekuestrohen 630 kg drogë e gomonia
Në faqen 12

LISTA E VI
Vendimet e vitit '97, emrat e 1462 pronarëve që do të kompensohen
Në faqen 18-19

KUR ESHTË PROVIMI
Filluan regjistrimet për konkurrim në koglejt 'Turgut Ozal' dhe 'Gulistan'
Në faqen 24

DOSSIER NGA DASHNOR KALOÇI



Raporti i dy piktorëve për KQ: Blerim Luzha na tha se Rexhep Ferrin e ka dërguar UDB-ja
Në faqen 10-11

Mjekja Migena Kika: Sindroma "Shaken Baby", dëmtime të rënda në tru e shtyllë kurrizore

Ylli Merja: Dieta për trajtimin e kolesterolit e diabetit

Mjeku popullor: Sa më shumë proteina, vitamina e kripëra minerale...

Nga VOLTIZA DURO
Kur jeta e individit pas moshës 50 vjeçare ka ardhur e shoqëruar me kolesterol të lartë, çregullime të tensionit, apo diabet, duhet të tregohet një kujdes tejet i veçantë e një ushqyerje e shëndetshme. Dieta ush-

Migena Kika:
Abuzimi fizik me



Mjeku Popullor
Cil më mirë për...
Cil më mirë për...
Cil më mirë për...



qimore për këtë kategori njerëzish (vuanë nga diabeti e kolesterolit lartë) është hapi i parë për një jetesë sa më të shëndetshme. Gjithashtu, dinamika e tyre e lëvizjes ndihmon në zvogëlimin e patologjive të ndryshme, e organizmi i këtyre...
Suplement

PROTESTAT NE KUKES ARRESTIMET

"Të hiqet taksa për Rrugën e Kombit, do të protestojmë sërish. Rama ik!"

Protesta e dhunshme, policia e Specialët "blindojnë" Kukësin, arrestohen 23 persona

Banorët dynden para komisarariatit: Policët na mësynë banesat dhe na terrorizuan, lironi djemtë tanë!

KUKËS

Një ditë pas protestës së zhvilluar në Rrugën e Kombit (pranë Tunelit të Kalimashit), e cila degjeneroi në dhunë dhe shkatërrimin e kabineve të kalimit me pagesë së automjeteve, prokuroria e Kukësit ka lëshuar 36 urdhër ndalime. Ndërkaq, policia e qytetit verior dhe forcat speciale nga Tirana kanë mundur të ekzekutojnë urdhër ndalimet për 23 protestues, të cilët u përleshën me forcat e rendit dhe i vunë flakën sporteve të biletave që do të mbledhin taksat për rrugën në fjalë. Pas paralajmërimit të ministrit të Brendshëm, Fatmir Xhafaj, se do të merren masa ndaj personave përgjegjës për protestën e dhunshme ka filluar aksioni. Gjatë natës dhe në orët e para të mëngjesit të djeshëm, blutë, Forcat e Ndërhjës së Shpejtë dhe RENEA kanë blinduar rrugët e qytetit verilindor, ndërsa kanë mësyre në banesat e personave që kanë qenë pjesë e protestës dhe kanë ndaluar 23 prej tyre, ndërsa 13 të tjerë janë shpallur në kërkim. Burime për "Gazeta Shqiptare" dje bënë me dije se në mesin e personave të ndaluar, përgjithësisht janë banorët të qytetit të Kukësit dhe të rrethinave dhe se nuk ka asnjë shtetas kosovar. Sipas burimeve zyrtare nga policia, materialet në ngarkim të protestuesve i janë referuar për veprime të mëtejshme prokurorisë së Kukësit për veprat penale: "Shkatërrimi i pronës", "Shkatërrimi i pronës me zjarr" dhe "Kundërshtimi i punonjësit të rendit publik".



Protesta e djeshme para komisarariatit të policisë së Kukësit

36

URDHËR NDALIME

Prokuroria e Kukësit ka lëshuar 36 urdhër ndalime në lidhje me protestën e zhvilluar dy ditë më parë në Rrugën e Kombit, ndërkohë që policia ka ekzekutuar urdhër ndalimet për 23 persona. Sipas bluve, këta persona akuzohen për veprat penale: "Shkatërrimi i pronës", "Shkatërrimi i pronës me zjarr" dhe "Kundërshtimi i punonjësit të rendit publik".



PERSONAT E NDALUAR NË KUKËS

1. Rasim Koloshi, 23 vjeç, banues në Kukës.
2. Rasim Onuzi, 38 vjeç, banues në fshatin Nangë, Kukës.
3. Florin Onuzi, 35 vjeç, banues në fshatin Nangë, Kukës.
4. Shaban Selmani, 60 vjeç, banues në Kukës.
5. Zenel Matmuja, 48 vjeç, banues në Kukës.
6. Adem Duraku, 59 vjeç, banues në fshatin Morinë, Kukës.
7. Xhevahir Gashi, 33 vjeç, banues në fshatin Nangë, Kukës.
8. Armand Ademaj, 28 vjeç, banues në Kukës.
9. Edmond Matmuja, 21 vjeç, banues në fshatin Pobreg, Kukës.
10. Elton Cengu, 39 vjeç, banues në Kukës.
11. Lefter Rexhmati, 38 vjeç, banues në fshatin Bushat, Kukës.
12. Shpëtim Toda, 44 vjeç, banues në Kolsh, Kukës.
13. Xhevahir Hereni, 51 vjeç, banues në Kukës.
14. Shemi Trota, 54 vjeç, banues në Shtiqën, Kukës.
15. Vasil Laçi, 31 vjeç, banues në Kukës.
16. Lulëzim Uka, 33 vjeç, banues në Kukës.
17. Ervis Oruçi, 25 vjeç, banues në Kukës.
18. Ardit Alidini, 21 vjeç, banues në Kukës.
19. Fatos Harulla, 33 vjeç, banues në Kukës.
20. Sajmir Trota, 33 vjeç, banues në Kukës.
21. Lulzim Popa, 60 vjeç, banues në Kukës.
22. Shkëlqim Vata, 42 vjeç, banues në Surroj, Kukës.
23. Abdi Haziraj, 49 vjeç, banues në Kukës.

"Nuk negociojmë, nëse nuk lirohen të arrestuarit"

Reagon këshilli bashkiak i Kukësit: Distancohemi nga dhuna, kemi 5 kushte për qeverinë

KUKËS - Këshilli Bashkiak i Kukësit ka reaguar pas protestës së djeshme të zhvilluar kundër tarifës së Rrugës së Kombit. Ky këshill ka paraqitur një deklaratë me 5 pika ku kërkon kryesisht lirimin e banorëve të arrestuar gjatë protestës. "Ngjarjet e ditës së djeshme (së shtrunës) të ndikuara nga rrethana të bëra të njohura para fillimit të protestës degjeneruan në aktë të dhunshme. Si rrjedhojë



situata doli jashtë kontrollit. Distancohemi nga çdo akt dhune. Me anëtarët e këshillit bashkiak kërkojmë: 1-lir-

imin e të gjithë të ndaluarve nga forcat e rendit; 2-ndalimin e arrestimeve të mëtejshme; 3-largimin e forcave speciale nga Kukësi, të cilat janë munduar të ushtrorin terror gjatë arrestimeve; 4-deklarim të se tarifa për Rrugën e Kombit është e panegociueshme; 5-çdo tentativë për negociatë nuk merret në konsideratë deri në lirimin e të arrestuarve", shkruhet në deklaratën e siguruar nga "Gazeta Shqiptare".

REAGIMI I BANORËVE

Ndalimet e dhjetëra protestuesve ka tensionuar situatën në Kukës. Të afërmit e personave të ndaluar deklaruan se janë provokuar nga policia, e cila, sipas tyre, i ka sharë dhe i ka sulmuar me gurë. "Policia erdhi rreth orës 03:00 të mëngjesit. Më arrestuan vëllain. Një arrestim i pabesueshëm, pasi ai nuk ka qenë në protestë. Unë dhe vëllai ishim në punë, pasi punojmë në një

kompani private. Të lirohet sa më parë", u shpreh vëllai i 44-vjeçarit Shpëtim Toda, i cili është ndaluar nga policia. Ndërsa, vëllai i protestuesit të ndaluar Elton Cengu tha: "Vëllain ma morën me forcë sot (dje) në ora 04:00 të mëngjesit. U futën me forcë në banesë. U ngrit mamia me hap derën, ndërsa policia tentoi të merrte dhe vëllain tjetër; i cili ka qenë në punë dhe nuk ka lidhje me protestën. Policët hynë si

kriminelë në shtëpi, duke i rënë derës me qyta armësh. Bënë terror. Sot (dje) erdhëm në komisarariat dhe pyetëm për vëllain, na thanë se nuk dinë gjë. Atëherë paskan qenë kriminelë ata që erdhën dhe morën vëllain. Se besoj se është arrestim. Do i denoncoj për rrëmbim. Kush ka bërë gjë le t'i marrin. Ne s'na duhet gjë ajo punë. Ne s'kemi ardhur të shkatërojmë asgjë, se është pronë private, jo pronë e përbashkët, si thotë ai shefi jonë, ai i gjati. Mbese është e atij, s'na hyn ajo pjesë. Ne na duhet pjesa jonë. Kemi dalë të protestojmë se për ne, taksa 5 euro është shumë barrë e rëndë". Ndërsa, nëna e Elton Cengut u shpreh: "Erdhën në 4 të natës na nxorën prej

shtëpisë. Qenë duke më marrë edhe mua me vete, se ka shkuar në protestë Eltoni". Ndërsa, një tjetër banor pohoi: "Në orën 4 të mëngjesit ka ardhur policia, na është futur në shtëpi dhe kanë kërkuar dy djemtë. Njëri, i vogli është në arrest shtëpie, ka katër muaj. I madhi nuk ndodhet se ka shkuar në Tiranë për t'u bërë operacion për varicet. Ka ndodhur që është gjendur atje te tuneli dhe e kanë ndal atje, si të tjerët. Mirëpo, djalin e vogël në arrest ma morën dhe unë nuk e di se ku është". Një i moshuar para komisarariatit të policisë tha: "Më arrestuan dhëndërin. Erdhën në 4 të mëngjesit 20 policë. E morën me vete se ka qenë në protestë".



Situatë e tensionuar në kryeqytet, protestuesit hyjnë te Drejtoria e Policisë

23 të arrestuarit në Tiranë, të martën nisen me blinda në Kukës

Shehu kusht Ramës: S'të takoj pa i liruar

Njëzetetë të arrestuarit nga Kukësi janë sjellë në Tiranë për arsye sigurie dhe për mungesë ambientesh në komisarjatin e Kukësit. Dymbëdhjetë prej tyre ndodhën në paraburgimin e drejtorisë së Policisë ndërsa 13 të tjerë janë shpërndarë në komisarjat 1, 2 e 3 po në Tiranë. Ata do të dalin të martën para trupit gjyqës dhe do të shoqërohen me blinda drejt qytetit verilindor. Ky vendim u bë shkak për zhvendosjen e protestës nga Kukësi në Tiranë, protestë e cila nisi me pak njerëz por shpejt u shtua në numër. Qytetarë pjesë e shoqërisë civile me thirrjet: Lironi Vëllezërit tanë... tentuan të hyjnë në ambientet e drejtorisë së Policisë së kryeqytetit. Në videot e shfaqura dëgjohej zëra që thonë: Futu... Hyni... Hapni rrugën, poshtë Qeveria, poshtë diktatura. Protestuesit u mblohdën në Tiranë pasditen e djeshme ndërsa thanë se s'do të largohen pa u liruar 23 të arrestuarit nga Kukësi. "Policia e Kukësit ka ekzekutuar urdhër-ndalimet e Prokurorisë pasi gjatë protestës së zhvilluar në datë 31 mars në Rrugën e Kombit, pranë Tunelit të Kalimashit, te kabinat e kalimit me pagesë të automjeteve, kanë ushtruar dhunë ndaj punonjësve të policisë, si dhe kanë shkatërruar me zjarr kabinat dhe disa zyra të ko-



Protestuesit dje në mbremje brenda ambienteve të Drejtorisë së Policisë

mpanisë", thuhet në njoftimin e policisë. Ndërkaq aktivistët në Tiranë nuk kanë pranuar politikanë në mesin e tyre duke thënë që kjo është çështje që nuk i përket atyre. **KRYEBASHKIAKU** Kryetari i Bashkisë së Kukësit, Bashkim Shehu e konsideroi shtettrëhim policor atë që po ndodh në qytetin verilindor, duke i bërë thirrje policisë që të tërhiqet. Nga ana tjetër ai i bëri thirrje qeverisë që të gjejë zgjidhje për situatën në fjalë, që çoi në arrestimin e 23 protestuesve. Ai i kërkoi autoriteteve që të liroheshin qytetarët, pasi kjo çështje nuk zgjidhet sipas tij me arrestime. Mes të tjerash ai i vuri një kusht kryeministrit Edi Rama, ndërsa i tha këti

të fundit që mund të takoheshin vetëm nëse liroheshin protestuesit. "Unë i bëj kërkesë kryeministrit, ministrave, iu bëj thirrje që të ulen dhe të negociojnë. Duhet transparencë. Brenda ka protestues, njerëz të ndershëm, socialistë të ndershëm, dhe kjo çështje nuk bëhet me arrestime. Ndaj hetimi duhet të jetë transparent dhe qytetarët të lirohen", -tha z.Shehu. Ai u shpreh në mbështetje të qytetarëve kukësi që protestojnë kundër tarifës së Rrugën e Kombit. "Qeveria e ka detyrim ligjor t'i dëgjojë qytetarët e Kukësit. Le të vijë përmes institucioneve zyrtare të komunikojë me qytetarët. Unë e kam deklaruar që nuk jam kundër taksave. Por të gjendet një

tarifë e përshtatshme." Unë nuk vdiqa të jem kryetar bashkie. Jam i zgjedhur i qethtarëve të Kukësit dhe i përfaqësorja ata. I bëj thirrje qytetarëve të Shqipërisë t'i bashkohen qytetarëve kukësi. Ata janë njerëz halexhinj, që protestojnë për halllet e tyre. Unë jam protestave të qeta. Edhe protesta e djeshme ka qenë e qetë, por pastaj pati provokime", u shpreh kryebashkiaku i Kukësit. Më herët kryebashkiaku i Kukësit priti dje në zyrën e tij familjarët e të arrestuarve nga policia të cilëve u premtuar se është në krahun e tyre. Shehu i vuri në dijeni se ka kontaktuar edhe me kryeministrin Rama dhe me Presidentin Meta, për situatën.

Ambasadori britanik: Dhuna nuk është zgjidhje!

Ambasadori britanik në vendin tonë, Duncan Norman, reagoi dje lidhur me përplasje e së shtunës të protestuesve me policinë në Rrugën e Kombit. Ai shprehet se dhuna nuk është zgjidhje. Përmes një reagimi në "Twitter" ambasadori theksoi se ishte thellësisht i mërzitur nga ngjarjet në fjalë. "Të trishtuar nga plagët e shkaktuara në incidentin e djeshëm në autostradën e Kukësit. Dhuna nuk është përgjigja"-shkruan ambasadori. Policia njoftoi dje se për dhunën gjatë protestës ka arrestuar 23 persona. Arrestimi i protestuesve solli reagimin e ashpër të qytetarëve të Kukësit, por edhe opozitës. Protestuesit shkatërruan dhe i vunë flakën sporteve të biletave ku do të bëhej edhe pagesa për taksën e Rrugës së Kombit.



Berisha publikon pamjet:

Policia gjuan me gurë protestuesit

Një ditë pas protestës së dhunshme në Rrugën e Kombit, ku pati përplasje mes protestuesve dhe policisë, vijojnë të publikohen dhjetëra filmime të bëra nga qytetarët. Në disa prej tyre, dallohen edhe e sjelljet provokuese nga ana e punonjësve të policisë ndaj protestuesve. Në një video të filmuar nga qytetarë pjesëmarrës në protestën e së shtunës, dhe të publikuar nga ish-kryeministri Sali Berisha, shihet sesi mes policëve me skafandra e mburoja, një polic qëllon me gurë mbi protestuesit. "Shikoni se si gangsterët me uniformë të narkopolicisë nxisin qytetarët që të gjuajnë me gurë! sb", shkruan ish-kryeministri Berisha.

FOTO LAJM

Ambasada amerikane ka uruar përmes një dëgjimore interesante 1 prillin, Ditën e Gënjeshtërave. Në postimin në faqen zyrtare në "Fb" të ambasadës, personazhet e fabulës janë ambasadori amerikan Lu dhe një tregtar peshku. Lu e pyet se kush janë peshqit e mëdhenj, teksa tregtari i tregon një sardelle bashkë me urimin e 1 prillit. Deklaratat e Lu-së për arrestimin e "peshqve të mëdhenj" të korruptsionit në vendin tonë kanë qenë të vazhdueshme, madje duke përcaktuar dhe afate kohore, por deri tani rrjeta nuk ka qenë me fat.

1 PRILLI, AMBASADORI LU NË KËRKIM TË "PESHQVE TË MËDHENJ"

Shitje me Ankannd te pare nga Studio Perbarimore L.D.C

- "Apartament" me nr. pasurie 1/1309+1-19, vol. 37, faqe 217, ZK. 8532, regjistruar ne Zyren Vendore te Regjistrimit te Pasurive te Paluajtshme Fier. Me cmim shitje 36.000 Euro

Data e shpalljes 15.03.2018
 Data e zhvillimit 11.04.2018 deri ne oren 16.00

Ankandi zhvillohet ne ambientet e zyres Studio Perbarimore L.D.C te ndodhur ne adresen: Rruga "Myslym Shyri", Vila 8/1, Kati 1, Tirane, e-mail: erjon.papalazzo@yahoo.com.

PROTESTA AKUZAT

Kreu i PD: Policia la të lirë Habilajt, ushtron terror ndaj qytetarëve të Kukësit

Basha thirrje Ramës: Hakmarrje, liro urgjentisht të arrestuarit

"Marku e njollosur, u ka hequr të drejtat padrejtësisht"

Valentina Madani

Kreu i opozitës Lulzim Basha i bëri mbrëmë thirrje kryeministrit Edi Rama të tërhiqet nga "hetimi i tij politik dhe të lirojë njerëzit e pafajshëm". Kurse kryeprokuroren Arta Marku e akuzoi se ajo po punon si hetuesi i Edi Ramës. Basha po ashtu i kujtoi të shkuarën dhe tha se Marku ka një të shkuar të njollosur dhe ka hequr të drejtat padrejtësisht qytetarëve. "I bëjmë thirrje prokurorisë që të ndalë menjëherë këtë gjë të lë të lirë të gjithë të arrestuarit. Ajo ka një të shkuar të njollosur nga kufizime të padrejta të kufizimit të lirë së qytetarëve. Të ndal menjëherë së vepruari si hetuesi politik e Edi Ramës. Prokuroria duhet të shpallë prioritet kombëtar luftën kundër drogës, dosjet e Saimir Tahirit, Dakos, Gjokurit, Beqajt, Balilit, Habilajt, dhe kriminelëve të tjerë, që duhet të jenë fokusi i saj", deklaroi Basha. Sipas tij kjo polici lë të lirë, Balilin, Agron Xhafën, Habilajt dhe dhjetëra kriminelë të tjerë, u hodh me urdhër kundër popullit në Kukës. "Aktet që kanë bërë protestuesit janë vepra të lehta, që parashikohet gjobë ose burg deri në tre vite. Arrestimet e kryera natën kanë vetëm një qëllim ushtrimin e terrorit dhe banorët të mos ngrënë zërin kundër zhvajtjes që u bëhet. Ata janë arrestuar nga policia pa asnjë urdhër ndalimi dhe urdhër arrestimi, dhe përbën vepër të rëndë penale dhe këshilli bashkiak ka bërë një kallëzim. Ne kërkojmë lirinë e menjëhershme e të arrestuarve", - u shpreh kreu i PD-së. Më herët kreu i PD-së Lulzim Basha dënoi arrestimin e 23 protestuesve në Kukës, të cilët në shenjë kundërshtie u konfrontuan me policinë dhe i vunë zjarin sporteve të biletave për taksën e Rrugës së Kombit. Basha i konsideron veprimet e prokurorisë për urdhër-arrestet në Kukës të diktura politikisht nga kryeministri Rama. Basha shprehet se policia dhe prokuroria janë të dorëzuara para trafikantëve



Kreu i PD-së, Lulzim Basha, mbrëmë në konferencën për shtyp

ABUZIMI

"Vjedhja dhe shpërdorimi i fondit 200 milionë euro është arsyeja pse Rama vendosi tarifën nga 5 në 32 euro në Rrugën e Kombit. Do të mjaftonte një e dhjeta e këtij fondi për këtë mirëmbajtje. Rama zhvat qytetarët me tarifën e Rrugës së Kombit për të mbuluar vjedhjen e fondit 200 milionë euro në vit. Tarifa e Rrugës së Kombit duhet të hiqet", -tha z.Basha.



Protesta në Rrugën e Kombit

Arrestimet, Boçi: Rama Shën Bartolomeu kuksian

Deputeti demokrat Luçiano Boçi e quan Kryeministrin Rama të pabesë. Ky reagim i tij vjen pas arrestimeve të bëra mesnatën e mbrëmshme në Kukës. Boçi shkruan në një postim në rrjetin social "Facebook" se dhe Rama bëri sikur i shtriu dorën duke i marrë frymën nga frika dhe tmerrin dhe sot nën ethe dhe humbjes së pushtetit ngriti dorën në 3 të mëngjesit ndaj banorëve të Kukësit. "SHËN BARTOLOMEU KUKSIAN. Pabesia e Ramës është epike. Nuk po përmend pabesinë e tij me miqtë e të afermit. As ato pabesi politike që i përdor si menciuri. Po i përmend pabesinë e pafundme me njerëzit e votuesit. Dje bëri sikur i shtriu dorën, duke iu marrë frymën nga tmerrin e frikës, kuksianëve. Sot nën ethe dhe humbjes së pushtetit, në 3 të mëngjesit i ngriti dorën me një masakër krahinore në emër "të besimit të vet politik", duke dufuar dhe me gazetarët për vandalë e skenarë. Ia shënoi portat me të kuqe, pasi i premtoi bisedime dhe i dërgoi "qehajat speciale" për t'i arrestuar. Por mos të harrojmë: Pushteti mbretëror i Charlit IX u rrokullis pikërisht pas natës së Shën Bartolomeut", - shprehet z.Boçi.

Kryetarja e LSI dënon arrestimin e protestuesve

Kryemadhi: Kukësi nuk paguan taksë për orekset e Edi Ramës



Kryetarja e LSI-së, Monika Kryemadhi

Kryetarja e LSI-së, dënoi dhe dhunën e ushtruar nga Policia e Shtetit ndaj protestuesve në Kukës. Në një deklaratë të gjatë në "FB", Kryemadhi shprehet se veprime të tilla janë rishfaqje e arrogancës dhe frikës që ka pushtuar Edi Ramën këto 24 orët e fundit. "Qytetarët e ndaluar barbarisht me format dhe metodat e Sigurimit të Shtetit tregojnë qartë, se sado të përpigjen ish-bashkëpunëtorët dhe pinjollët e komunizmit i kanë të shënuar thellë në ndërgejeje metodat staliniste, deklaroi zj.Kryemadhi. Ajo garantoj protestuesit që mbahen në komisarjat e Tiranës se kanë mbështetjen e LSI-së. "Siguroj të ndaluarit nga policia dhe familjarët e tyre se kjo histori nuk mbaron këtu! Ne do të kërkojmë me forcën tonë dhe të ligjit, jo vetëm lirinë e tyre, por edhe rikthimin e dinjitetit të nëpërkëmbur nga falangat e qeverisë. Edi Rama që

kërcënon banorët e Kukësit dhe protestuesit e ndaluar, bën mirë të angazhojë policinë, forcat speciale, prokurorinë, madje dhe vetë Saimir Tahirin po të dojë, që të gjejë ish-drejtesit e policisë të arratisur dhe të përfshirë në trafikun e lëndëve narkotike"-tha ajo. Kryetarja e LSI-së thekson se askush nuk mund t'i detyrojë qytetarët e Kukësit dhe zonave për-

reth, që në skajshmërinë e varfërisë, ku i ka çuar kjo qeveri, të paguajnë taksë për orekset e klientëve të Edi Ramës. "Asnjë vegël e Edi Ramës, apo goftë dhe ai vetë, nuk do të mundin të dhunojnë të drejtën e banorëve të Kukësit për të mos u varfëruar çdo ditë e më shumë për hir të qejfëve dhe perversitetëve të një kryeministri të papërgjegjshëm. LSI

TARIFA

"Ne si LSI, jemi të bindur në betejën tonë për ndryshimin e tarifës dhe mbështetjes ekonomike për banorët e kësaj zone", - shprehet Kryemadhi.

dhe opozita shqiptare do të vazhdojë të jetë në krah të banorëve protestues dhe do të kundërshtojë çdo akt dhune apo presion që përpigjet të frikësojë Kukësin dhe kuksianët. Ne do të vijojmë përpjekjen dhe betejën tonë për të rikthyer besimin të shqiptarët e gënjyer dhe zhgënjyer nga qeveria e narkotrafikut", - theksoi zj.Kryemadhi.

para trafikantëve të drogës dhe kriminit të organizuar, por po keqpërdoren kundër qytetarëve që protestojnë kundër një tarife korruptive që i grabit, varfëron dhe i izolon për të pasuruar Edi Ramën dhe bandën e tij", - deklaroi z.Basha.

të drogës dhe kriminit të organizuar. Z.Basha theksoi se prokuroria dhe policia janë të urdhëruara nga Rama, ndër-sa arrestimet janë veç një hakmarrje. "Dënoj ashpërsisht arrestimet në mes të natës të qytetarëve dhe dërgimin e tyre në Tiranë, të



Konsultime me qeverinë e Kosovës për tarifën, kryeministri: E pse duhet?

Rruga e Kombit, Rama: Nuk ka tërheqje, ata që dogjën, vandalë

"Rruga me pagesë, 5 eurot nuk negociohen"

Kryeministri Edi Rama e konsideroi dje "studi në gotë" atë që ndodhi në Rrugën e Kombit. Tarifa për kalimin e "Rrugës së Kombit" nuk do të ndryshojë. Gjatë bashkëbisedimit me gazetaret kryeministri Edi Rama theksoi qartë se pagesa prej 5 euro për automjetet nuk do të preket. Lehtësi do të kenë vetëm banorët e zonës verilindore, të cilët e frekuentojnë më shumë këtë aks. Sa i takon protestës së të shtunës, kreu i qeverisë bëri dallimin mes atyre që i konsideroi vandalë të orientuar nga politika e Tiranës dhe qytetarëve që nuk u bënë pjesë e akteve të dhunës. Sipas tij të gjithë ata që ushtruan akte dhune, do të përgjigjen përpara drejtësisë. "Dezinformimi dhe manipulimi i opinionit publik dhe posaçërisht në Kukës ka triumfuar mbi shpjegimet që ne kemi dhënë. Të tërhiqesh nuk është asnjëherë e paudhë. Këtu nuk ka asnjë tërheqje për të bërë, por thjesht ka nevojë për të luftuar dezinformimin. Më vjen shumë keq që në këtë proces, pasi kjo kontratë është e nënshkruar prej dy vjetësh, pasi një vit që kompania ka filluar punë dhe ka bërë goxha punë dhe ngrihet një furtunë në gotë" dhe ndizet benzinë mbi pronën e përbashkët dhe një investim që duhet ta dëmshpërblejë përsëri buxheti i përbashkët. Në këtë fushatë dezinformimi ne mund të kishim bërë më shumë. Kur këto investime sulmohen dhe digjen nga vandalë, sigurisht që kush ka bërë investimet kërkon mbrapsht paratë nga shteti. Kjo nuk ka nevojë të parashikohet në kontratë", deklaroi z.Rama. Kryeministri mohoi të ketë pasur kontakte apo këshillime mbi vendosjen e tarifës prej 5 euro, mes ekzekutivit të Tiranës e atij në Prishtinë, nisur nga fakti se rruga frekuentohet masivisht edhe nga qytetarët kosovarë. Pagesa për kalimin në akte të rëndësishme, nuk do të aplikohet vetëm tek Rruga e Kombit, saktësisht Rama. Shefi i ekzekutivit theksoi se Rruga e Kombit, ka nevojë për mirëmbajtje dhe riparime të rëndësishme. 37 janë vatrat potenciale të rrezikshme për rreshqitje të tokës, ndërkohe që do të kryhen 30 milionë euro investime, riparim të rrugës së Kukësit, 7 mbikalime të reja, si dhe studim i ri gjeologjik. "Nuk ka shans të tërhiqemi për një arsye të thjeshtë. Në një hark kohor 5 deri në 10-vjeçar rruga do të jetë e pa-



Kryeministri Edi Rama

DEKLARATA

Z.Rama theksoi se tarifa prej 5 eurosh nuk negociohet dhe se mbajtja e rrugës pa pagesë është e pamundur. Ai garantoi banorët e zonës se do të kenë abone, e cila do të mundësojë një tarifë të reduktuar të lëvizjes për ta.

"Protestuesit e Kukësit vandalë"

Vasili i përgjigjet Ramës: I pa fe, blasfemoi edhe ditën e Pashkës

Kreu i Grupit Parlamentar të LSI, Petrit Vasili, reagoi dje pas deklaratave të kryeministrit Rama për protestën e një ditë më parë në Rrugën e Kombit, duke i quajtur protestuesit vandalë. Përmes një reagimi në rrjetin social "Facebook", ai e etiketon si të pa fe kryeministrin Rama, i cili sipas tij blasfemoi edhe në ditën e Pashkës. "Kryeministri vandal dhe i pa fe, blasfemoi edhe sot ditën e Pashkës. Sot ditën e Pashkës ky kryeministër, që urren zotin, blasfemoi sot dhe në vend të urimeve lëshoi mallkime për Kukësin dhe kuksianët. Kryeministri përpigjet të gjejë frymëmarrjen e humbur tek narkotrafikantët, që me avionë filluan sërish drogën dhe quan popullin vandal. Dhe kush e bën këtë? Kryeministri vandal që shkatërroi ekonominë, që i varfëroi deri në mjerim shqiptarët, ai që bëri që edhe fëmijët nga 7-17 vjeç të marrin arratinë nga ky vend, ky që i hapi jo gropa, por humnera financiare me koncesionet. Ky vandal politik, armik i egër i Shqipërisë e që urren shqiptarët dhe i krahason me organin e maskullit, duhet të ikë",- shprehet z.Vasili.

Luan Rama: As hasmi nuk preket në ditë të shenjtë

Nënkryetari i LSI-së, Luan Rama sulmoi dje kryeministrin Rama lidhur me cilësimin e protestuesve në Kukës si vandalë. Ai tha se malësorët nuk janë vandalë, ndërsa sipas tij kryeministri po vijon me fyerjet për këto zona. "Malësorët nuk janë vandalë, z.Kryeministër! Rama i përfshirë prej paranojës e frikës, vazhdon të fyejë e provokojë banorët e Lumës, Hasit, Prizrenit e Malësisë së Gjakovës, duke i etiketuar ata malokë e vandalë! E për më keq akoma, përpigjet t'i terrorizojë e kërcënojë, madje edhe në një ditë të shenjtë, duke shkelur mbi një kod të lashtë sa vetë jeta, sepse në ditë të tilla as hasmi nuk preket! Malësorët nuk janë vandalë! Ata janë qytetarë të vendit ku je Kryeministër, janë me një mijë halle që qeverisja jote jua ka bërë edhe më të rënda e të padurueshme! Ndaj duhet t'iu kërkojmë falje për etiketimet fyese që ke përdorur ndaj tyre! Duhet t'ju kërkojmë falje për kërcënimet dhe për klonin që kërkon të vesh për t'i ndarë kuksianët, trojpanjët, hasjanët e kosovarët nga pjesa tjetër e atdheut! Në të kundërt përgjegjësia është e jotja",- theksoi z.Rama.

LSI: Policia larg politika diktatoriale e Ramës

Spaho në Kukës: Ndalni arrestimet, rrezikohet përshkallëzimi i situatës

Një ditë pas protestave të dhunshme në Rrugën e Kombit, ku protestuesit u përplasën me policinë, deputetët e opozitës udhëtuan drejt komisarariatit të Kukësit duke apeluar për lirimin e të ndaluarve. Kreu i Grupit Parlamentar të PD-së, Edmond Spaho nga godina e policisë së Kukësit kërkoi që të ndalen arrestimet për protestën, duke theksuar se situata mund të përshkallëzohet nëse vazhdohet në këtë formë. "Atij i thamë që i ka prerë në besë qytetarët e Kukësit, pasi u është kërkuar që në këmbim të anulimit të protestës nuk do të arrestohet njeri. Gjatë natës si në diktaturë janë arrestuar 24 persona dhe janë lëshuar urdhrë-arreste edhe për atë të tjerë. I kërkuam drejtorit ta ndërpresë këtë klimë, i kërkuam që të li-



rojnë të arrestuarit që i kanë çuar në Tiranë dhe t'iu femi rrugës të dialogut. Nëse vazhdohet kështu situata mund të eskalojë. Shpresoj që ky zë të jetë dëgjuar", deklaroi z.Spaho. Ndërsa deputetja e LSI-së Nora Malaj shtoi se mes të ndaluarve ka edhe persona të mosshuar. "Iu bë ndalesa sikur

ishin kriminelë, të ndaluarit janë në Tiranë", tha deputetja Malaj. Deputeti i LSI, Endrit Braimllari nga jashtë ambienteve të komisarariatit të Kukësit, ku takoi drejtuesit e policisë, akuzoi kryeministrin Edi Rama se ky i fundit po instalon sistemin diktatorial në Shqipëri. Ligjvënësi opozitar theksoi se arrestimet janë dëshmie e qartë e frikës dhe shtypjes së protestës. "Edi Rama po instalon sistemin diktatorial në Shqipëri. Arrestimet e bëra janë dëshmia e frikës dhe e shtypjes së protestat. Kemi kërkuar të lirohen të ndaluarit, kemi kërkuar listën e të ndaluarave pasi është e paqartë. I bëjmë thirrje Policisë së Shtetit të distancohet nga politika diktatoriale e Edi Ramës. Edi Rama nuk mund të ndajë dot shqiptarët", tha Braimllari.

përdorshme. Midis rehatisë dhe komoditetit në karrige do të shtyrë kohën e qëndrimit pa siklete dhe marrjes së vendimit për të garantuar rrugën, zgjedhja për mua është e qartë. Rruga do të jetë me pagesë kjo diskutohet. 5 eurot nuk negociohen", theksoi z.Rama. Ai siguroi se do të ketë abone për banorët me përdorim të shpeshtë. "Në kontratë do të aplikohet sistemi për përdoruesit e shpeshtë që banojnë në atë

zonë. Të tjerët janë përdorues të rrallë. Për banorët do të ketë një sistem të posaçëm që do t'u shërbejë të gjithë atyre që janë përdorues të rrugës që do të marrin abone dhe vetvetiu do të ulet çmimi",-u shpreh kryeministri. I pyetur nga gazetarët nëse ishte konsultuar me qeverinë e Kosovës për tarifën e kalimit në Rrugën e Kombit, Rama deklaroi se nuk kishte arsye për ta diskutuar, ndërsa shtoi se pagimi i kësaj tarife është

patriotizëm. "E pse duhet? Cila ishte arsyeja që duhet të konsultoheshim? Së pari, nuk është taksë. Këtu dëgjojmë njerëz që thonë janë rritur taksat, sepse quhet taksat pagesën e dritave dhe ujit. Së dyti, nuk kemi arsye ta konsultojmë, sepse nuk është një tarifë e vendosur politikisht. Çfarë do të diskutonim ne me qeverinë e Kosovës? Kjo nuk është tarifë patriotizmi. Patriotizëm është ta paguash tarifën",-tha Rama.

ZGJEDHJET NE PD

INTERVISTA

Sekretari i PD: Bashkëjetesa arrihet "me këmbë në tokë", duke lëshuar të gjithë nga pak

Bozdo: Qëndrimi në frëngji pasi ke "qit pushkë", nuk sjell bashkim

"Zgjedhjet e përgjithshme, më afër nga ç'mund të imagjinohet!"

Valentina Madani

Demokratët kanë mbyllur procesin e analizës në mbarë vendin duke identifikuar shkaqet e brendshme dhe të jashtme të humbjes së thellë të 25 qershorit 2017. Sekretari organizativ i PD-së Enno Bozdo thotë për "Gazeta Shqiptare", se raportet e hollësishme për çdo degë dhe për çdo qark do t'i shërbejnë lidhshmërisë të PD-së të ndërtojnë strategji dhe të ndërmarrë riorganizim në përpunje me rrethanat e krijuara, për të maksimizuar votën për PD-në në zgjedhjet më të afërta. Por deri atëherë sipas Bozdos duhet lidhshmëria dhe aksion politik pasi "kënetat sociale" e krijuar në Shqipëri është treguar e aftë të "thithë" pa shumë zhurmë zërin e denoncimit. Në kushte të tilla, sekretari organizativ beson se PD-ja është e destinuar të fitojë pasi shqiptarët po jetojnë nën diktaturën e Edi Ramës dhe prej duhet t'i shpëtojë PD-ja. Ai beson se zgjedhjet parlamentare janë më afër nga ç'mund të imagjinohet, ndaj Bozdo zbardh strategjinë e fitores së opozitës përmes bashkimit të vetë demokratëve.

Z.Bozdo, çfarë rezultoi nga mbyllja e procesit të analizës së PD-së?

Procesi i analizës zgjati për një periudhë tre muore dhe përfshiu të gjithë strukturat e Partisë Demokratike, nga qendra deri në bazë. Procesi u drejtua nga anëtarët e kryesisë qendrore, anëtarët e Këshillit Kombëtar, drejtues vendorë dhe qendrorë dhe u shtri deri tek anëtarët e thjeshtë. Analiza u zhvillua nën frymën e një angazhimi individual shumë serioz dhe absolutisht të ndershëm për sa i përket identifikimit të shkaqeve, të brendshme apo të jashtme, që sollën rezultatin e padëshiruar të zgjedhjeve 2017. Unë personalisht jam i impresionuar nga kthjelltësia politike e demokratëve, guximi për t'i thënë të vërtetat në



Sekretari organizativ i PD-së Enno Bozdo

ZGJEDHJET

"Në Kuvendin e PD-së pritet të miratohet ndryshimet statutoare si dhe të zgjidhet Këshilli i ri Kombëtar. Kjo potencialisht do t'i hapte rrugë me shpejtësi dy proceseve shumë të rëndësishme që zhvillohen paralelisht: riorganizimi strukturor, bazuar në konceptet e reja statutoare si dhe përzgjedhja e kandidatëve për zgjedhjet e ardhshme të pushtetit vendor".

BESUESHMËRIA

"Për të arritur të prekim fibrën e shoqërisë, për ta bindur atë të lëvizë, s'mjaftojnë vetëm fjalët me vend të folësit, por besueshmëria e atyre që flasin, integriteti i tyre individual dhe profesional. PD-ja ka shumë njerëz të tillë, madje më shumë se çdo parti tjetër. Suksesi do të përcaktohet nga angazhimi tërësor i tyre", -tha z.Bozdo.

sy, mirëkuptimi për rrethanat e rënda dhe kushtet e pabarabarta në të cilat u zhvilluan këto zgjedhje, por edhe ndjenja e përgjegjësive, në të gjitha nivelet, për gjëra që duhet t'i kishim bërë më mirë dhe menduar më mirë.

Në qarkun e Beratit ku kam qenë i deleguar, kam marrë pjesë në thujtje të gjitha analizat e zhvilluara në nivelin e grupseksionit dhe të kryesisë të pesë degëve që përmban ky qark. Janë më shumë se 230 diskutime të bëra nga anëtarësia në afro 40 takime, ku

gjërat janë thënë troç, pa doreza, me ndershmeri. Eshhtë vënë gishtin në plagë, pavarësisht se jo rrallë plagë ishte e jona. Eshhtë denoncuar qartazi droga dhe paratë e perdorura hapazi në fushatë për blerjen e votave, presioni maksimal ndaj administratës nga dy forcat e majta, PS dhe LSI, por edhe të metat jo të pakta si dhe problematikat tona të brendshme. Si përfundim, tashmë ka raporte të hollësishme për çdo degë dhe për çdo qark. Këto raporte të vlefshme do t'i shërbejnë lidhshmërisë të PD-

AKSION POLITIK

"Kënetat sociale" e krijuar në Shqipëri është treguar e aftë të "thithë" pa shumë zhurmë zërin e denoncimit. Kënetat duhet tharë. Pritat apo digat që e mbajnë atë të "gjallë" duhen hedhur në erë. E për këtë s'mjafton vetëm denoncimi, por nevojitet lidhshmëria dhe aksion politik", -tha z.Bozdo.

së të ndërtojnë strategji dhe të ndërmarrë riorganizim në përpunje me rrethanat e krijuara, për të maksimizuar votën për PD-në në zgjedhjet më të afërta.

Çfarë ka propozuar baza e PD-së dhe ku fokusohet kryesisht?

Identifikimi i problematikës, për shkaqet të brendshme apo të jashtme, ishte vetëm një pjesë e procesit të analizës. Por procesi përfshinte edhe konsultimin e anëtarësive në lidhje me aksionin politik të PD-së në rrethanat e krijuara, si dhe propozime konkrete për ndryshime statutoare me qëllim dhënies hov dhe frymëzimit të re jetës politike në Partinë Demokratike. Por unë do të ndalem veçanërisht në rekomandimet që vijjnë për ngritjen e aksionit politik dhe krijimin e frymës së fitores. Jetojmë në një realitet post-politik, shumë larg të qenit normal. E quaj të tillë, sepse çfarë ndodhë sot në rrafshin politik në Shqipëri, në thelb ka pak apo aspak lidhje me politikën e mirëfilltë. Degradimi i debatit publik si dhe supa e ftohtë e folësve dhe retorikës së konsumuar që na servitet çdo darrë tregon shumë mbi sëmundjen e shoqërisë. Shmangia e qëllimit nga diskutimi i temave më të rëndësishme për shoqërinë si p.sh. ekonomia, shëndetësia, korrupsioni, paaftësia administrative dhe mungesa e shtetit, kriminaliz-



Kreu i PD-së, Lulzim Basha, dje në Katedralen e Rrëshenit

imi i strukturave të tëra shetërore, është fenomen i përditshëm që mundësohet, me një farë suksesi, nga spin-off apo ndryshe fuga e pushtetit. Në këtë pike, "arritja" më e madhe e Ramës është ndjesia e adaptimit social me të keqen në atë përmasë sa që sot po gërryen tesutin social të vendit dhe po mpin aftësinë tonë për të reaguar si shoqëri e civilizuar.

Çfarë duhet të bëjë opozita përballë kësaj situatë...?

Përballë kësaj situatë, denoncimi i përditshëm është vërtetuar se nuk mjafton, sepse "kënetat sociale" e krijuar në Shqipëri është treguar e aftë të "thithë" pa shumë zhurmë zërin e denoncimit. Kënetat duhet tharë. Pritat apo digat që e mbajnë atë të

Për t'iu kthyer përsëri pyetjes tuaj: anëtarësia gjatë këtij procesi të konsultimit dhe analizës, drejtpërdrejtë dhe pa doreza, ka treguar mjetet dhe rrugën për të arritur pikërisht këtu. Pra, kush di të dëgjohet, do të gjejë edhe mesazhin brenda.

Në çfarë situatë janë aktualisht strukturat e PD-së? A janë dorëzuar listat e delegatëve nga të gjitha degët dhe sa delegatë do të jenë të pranishëm në Kuvendin e 28-29 prillit?

Bashkë me analizën kemi përfunduar tashmë edhe një proces të rëndësishme organizativ, që ka lidhje me strukturën dhe organizimin kapilar, të imët, të Partisë Demokratike. Nga pikëpamja organizative tashmë jemi plotë-

MANDATET

"Çdo përqasje tjetër ndaj axhendës së Kuvendit do të ishte në dëm të fitores së zgjedhjeve vendore dhe përgatitjes për zgjedhjet e përgjithshme, të cilat duket se janë më afër nga ç'mund të imagjinohet! Mandatet tashmë janë gati. Afro 7000 të mandatuar do të marrin pjesë në punimet e Kuvendit të PD-së."

gjallë" duhen hedhur në erë. E për këtë s'mjafton vetëm denoncimi, por nevojitet lidhshmëria dhe aksion politik. E mbi të gjitha besueshmëria të mesazhit dhe të mesazherit. Për të arritur të prekim fibrën e kësaj shoqërie, për ta bindur atë të lëvizë, nuk mjaftojnë vetëm fjalët me vend të folësit, por mbi të gjitha besueshmëria e atyre që flasin, integriteti i tyre individual dhe profesional. PD-ja ka shumë njerëz të tillë, ka madje më shumë se çdo forcë tjetër politike në Shqipëri. Suksesi do të përcaktohet nga angazhimi tërësor i tyre, me pak fjalë nga "oferta" që PD-ja do t'u afrojmë tashmë shqiptarëve.

sist të gatshëm të thërrasin Kuvendin e PD-së ku pritet të miratohet ndryshimet statutoare si dhe të zgjidhet Këshilli i ri Kombëtar i PD-së. Kjo potencialisht do t'i hapte rrugë me shpejtësi dy proceseve shumë të rëndësishme që zhvillohen paralelisht: riorganizimi strukturor, bazuar në konceptet e reja statutoare si dhe përzgjedhja e kandidatëve për zgjedhjet e ardhshme të pushtetit vendor. Në këtë mënyrë, lidhshmëria i ri i PD-së do të drejtonte procesin pa humbur aspak kohë. Në të gjithë këtë përqasje koha është thelbësore. Eshhtë përgjegjësia jonë ta kuptojmë siç duhet këtë çast



BASHKIMI

"Bashkimi apo bashkëjetesa arrihet duke qenë "me këmbë në tokë" dhe duke lëshuar të gjithë nga pak, për të gjitha ato që propozohen, apo edhe që kërkohen si kërkesa ultimative. Qëndrimi në frëngji dhe ngujimi pasi ke "qit pushkë", nuk sjell as bashkim dhe as bashkëjetesë.

dhe të veprojme pa humbur kohë, përtej axhendave personale. Sepse ne nuk mund të humbim as edhe një ditë duke u marrë me punët tona të brendshme, ndërsa zgjedhjet vendore janë në prag. Çdo përgasje tjetër ndaj axhendës së Kuvendit do të ishte në dëm të fitores së zgjedhjeve vendore dhe përgatitjes për zgjedhjet e përgjithshme, të cilat duket se janë më afër nga ç'mund të imagjinohet! Ndërkaq, mandatet tashmë janë gati. Afro 7000 të mandatuara do të marrin pjesë në punimet e Kuvendit të Partisë Demokratike.

Cilat janë propozimet kryesore që kanë ardhur nga baza dhe sa do të merren parasysh kërkesat e kritikëve për ndërhyrjet në statutin e partisë?

Propozimet që kanë ardhur nga baza, por edhe nga ata që duan të kontribuojnë me idetë e tyre, përfshijnë çështje që kanë lidhje me organizimin në terren të Partisë Demokratike, me mënyrën e funksionimit të organeve të saj vendimmarrëse, me mënyrën e përzgjedhjes së kandidatëve elektorale, me instrumente që mundësojnë përcimin e zërit të anëtarëve nga niveli më i poshtëm deri tek ai më i lartë. Këto koncepte janë trajtuar, gjithashtu, në mënyra dhe thellësi të ndryshme, në dy dokumente zyrtare të ardhur në Partinë Demokratike, të cilat reflektojnë propozime konkrete dhe në princip, për të adresuar disa çështje kritike të organizimit,

të rregullave të qarta të llojësi si dhe të sigurimit të hapësirave për të gjithë ata që kanë kontribut dhe duan të vazhdojnë të japin kontribut të mëtejshëm në Partinë Demokratike. Grupi i punës për këtë qëllim është duke trajtuar me shumë përgjegjësi të gjitha propozimet, me qëllim afërmim e tyre dhe konsolidimin mundësisht në një dokument të vetëm. Gjithsesi nuk është në tagrin e grupit të punës të vendosë për propozimet. Vetëm Kuvendi i PD-së do të vendosë për ndryshimet në statut.

A ka pasur takime, negociata me kritikët e Luzlim Bashës me qëllim sheshimin e pakënaqësive brenda së djathtës?

Ka pasur kontakte me të gjithë ata që kanë dashur dhe duan të kontribuojnë për një Parti Demokratike më të fortë.

Si mund të bëhet më e fortë, apo si mund të bashkohet PD-ja? Kush mund ta bashkojë atë dhe ta çojë atë drejt fitores?

Që të ketë bashkim duhet të ketë vullnet për të sheshtuar sa të mundim diferencat. Diferencat janë normale në politikë, qoftë edhe kur janë të thella. Por vecanërisht në këtë situatë, për t'i sheshtuar ato, nevojiten nga të gjithë vepime konkrete besimi.

Përfundimisht bashkimi apo bashkëjetesa arrihet duke qenë "me këmbë në tokë" dhe duke lëshuar të gjithë nga pak, për të gjitha ato që propozohen, apo edhe që kërkohen si kërkesa ultimative. Qëndrimi në

Kreu i PD-së nga Katedralja e Rrëshenit: Gëzuar Ditën e Ringjalljes

Presidenti Meta me familjen në kishë: Më e mira do të bëhet!

Berisha: Shpresë dhe besimi të pashuar të njeriut

Valentina Madani
Presidenti i Republikës, Ilir Meta së bashku me bashkëshorten, zonjën Monika Kryemadhi dhe fëmijët e tyre Borën, Besarin dhe Erën vizituan dje Arqipeshkvinë Metropolitane Tiranë-Durrës ku u pritën nga kryetari i Konferencës Ipehskvore dhe Arqipeshkvi katolik metropolitane, Imzot George Frenodo. Presidenti Meta uroi personalisht klerikëve e lartë të Kishës Katolike si dhe gjithë besimtarët katolikë Festën e shenjtë të Pashkëve për më tepër shpresë dhe optimizëm në këtë ditë të ringjalljes së shpresës e ripërtëritjes së besimit në Zot dhe në vlerat e virtytet më të mira shpirtërore dhe rritjes së dashurisë për njëri-tjetrin. "Doja të falënderoja Imzot Frenodon për ftesën dhe për këtë mundësi që këtë ditë kaq të rëndësishme ta kalojmë së bashku! Duke ju uruar të gjithëve Gëzuar Pashkët! Mbarësi për të gjithë ju e për familjet tuaja, jam i bindur se me besim të Zoti, por edhe me dashuri e solidaritet me njëri-tjetrin, më e mira do të bëhet!" - u shpreh Presidenti Meta. Duke nënvizuar mesazhin e rëndësishëm për t'iu gjendur sa më pranë shtresave në nevojë, Presidenti i Republikës dhe familja e tij së bashku me Imzot Frenodon



Presidenti Ilir Meta me personat me aftësi të kufizuara

MESAZHI

'Gëzuar Pashkët!' Mbarësi për të gjithë ju e për familjet tuaja, jam i bindur se me besim të Zoti, por edhe me dashuri e solidaritet me njëri-tjetrin, më e mira do të bëhet!" - u shpreh Presidenti Ilir Meta

morën pjesë në drekën e shtruar në Arqipeshkvi për personat me aftësi të kufizuara, duke ndarë me ta kremtimin dhe simbolikën e kësaj dite të bekuar. Urime për Pashkët kanë përcjellë përmes rrjeteve sociale kryeministri Rama, kreu i PD-së Luzlim Basha dhe ish-kryeministri Ber-

isha. Kreu i PD-së Luzlim Basha uroi nga Katedralja e Rrëshenit: "Dua të uroj të gjithë besimtarët katolikë për shumë vjet Gëzuar Pashkët. Ju uroj të gjithë besimtarëve shqiptarë, besimtarëve të Zotit, qoftë kjo ditë e ringjalljes, dita që shënon triumfin e jetës mbi vdekjen, e dritës mbi errë-

sirën, një ditë që i bashkon të gjithë shqiptarët në shpresën dhe besimin për një jetë më të mirë. Edhe njëherë Gëzuar Pashkët për shumë vjet". Me herët Basha uroi: "Festa e Pashkëve është kremtimi më i madh i kalendarit liturgjik të kishës katolike dhe të kishave të tjera të krishtera që krentojnë ringjalljen e Jezusit, e cila ka ndodhur sipas Besëlidhjes së Re, tri ditë pas vdekjes së tij në kryq", shprehet z.Basha. Kurse ish kryeministri Berisha shpërndau një video të Papa Françeskut dhe e cilësoi festën e Pashkëve ditën e Ringjalljes së Krishtit si dita e shpresës dhe besimit të pashuar të njeriut.

frëngji dhe ngujimi pasi ke "qit pushkë", nuk sjell as bashkim dhe as bashkëjetesë.

Në këto kushte që është sot PD-ja a mund të fitojë zgjedhjet e ardhshme lokale?

PD-ja është forca e vetme sot në spektrin politik shqiptar që ka të drejtën morale të denoncojë drogën, korupsionin galopant dhe mbytjen, krimin që ka zaptuar edhe kryeministrin, halabakërinë që po përçë qytetarrë nga vendi, rrënimin ekonomik dhe varfërinë

mbytëse. E ka fituar këtë të drejtë me qëndrimet e saj thellësisht parimore në këto 27 vite, qoftë në opozitë apo në pushtet. E vërteta është se data më të rëndësishme historike të Shqipërisë moderne, ndryshimet më të mëdha në të gjitha fushat si dhe progresi më i kuptimplotë ndonjëherë, janë arritur thuasje gjithmonë me kontributin e Partisë Demokratike, edhe kur kjo ka qenë në opozitë. PD-ja ka një forcë të madhe morale dhe intelektuale brenda saj, për të cilën

ndonosha edhe ne vetë në ndonjë rast, nuk kemi mjaftueshmërisht të ndërgjegjshëm. Kur të vendose ta nxjerrë këtë shpirt në pararojë, shpirtin e mbarë dhe fitues, pra në castin e

parë që PD-ja do të vendosë të fitojë zgjedhjet, ajo do t'i fitojë ato. PD-ja është e destinuar të fitojë dhe ta shpëtojë vendin nga kjo e keqe e madhe që ka pllakosur.

STRATI Shoqëria përmbarimore "STRATI BAILIFF'S SERVICE" Sh.p.k., rrijton shpalljen për shitjen në ankand të pasurive të paluajtshme:

- "Pyl", me sipërfaqe 6000 m², ndodhur në Qerret, Kavajë, me Nr. 1/422 Pasurie, Zona Kadastrale 3101, volumni 21, faqe 82, regjistruar në pronësi të Shoqërisë "Gjyzeli-BL" sh.a, lënë si garanci hipotekore për Bankën me Kontratë Hipotekore Nr. 2167 Rep., Nr. 1405/2 Kol., datë 23.08.2010. Cmimi fillestar i ankandit është 15.120.000 Lekë;
- "Pyl", me sipërfaqe 1000 m², ndodhur në Qerret, Kavajë, me Nr. 1/424 Pasurie, Zona Kadastrale 3101, volumni 21, faqe 81, regjistruar në pronësi të Ylli Braka dhe Emira Braka, lënë si garanci hipotekore për Bankën me Kontratë Hipotekore Nr. 2167 Rep., Nr. 1405/2 Kol., datë 23.08.2010. Cmimi fillestar i ankandit është 2.500.000 Lekë;
- "Trull", me sipërfaqe 2497 m², nga e cila 2497 m² trull dhe 161 m² ndërtëse ndodhur në Metalurgji Ebasan, me Nr. 432/3 Pasurie, Zona Kadastrale 3965, volumni 4, faqe 247, regjistruar në pronësi të Armand Shupit, lënë si garanci hipotekore për Bankën me Kontratë Hipotekore Nr. 2173 Rep., Nr. 1409/2 Kol., datë 24.08.2010. Cmimi fillestar i ankandit është 3.133.065.6 Lekë;
- "Arë+Trull", me sipërfaqe 4.500 m², nga e cila 400 m² trull dhe 176 m² ndërtëse, ndodhur në Sallmonë, Durrës, me Nr. 178/1 Pasurie, Zona Kadastrale 3255, volumni 6, faqe 135, regjistruar në pronësi të Bujar Gjyzi, lënë si garanci hipotekore për Bankën me Kontratë Hipotekore Nr. 657 Rep. Nr. 311/1 Kol., datë 11.08.2014 dhe Kontratë Hipotekore Nr. 1512 Rep., Nr. 1356/3 Kol., datë 23.10.2010. Cmimi fillestar i ankandit është 9.534.672 Lekë;
- "Dyqan", me sipërfaqe 60 m², ndodhur në Rrugë e Durrësit, Tiranë, Zona Kadastrale 6310, regjistruar në Regjistrin Hipotekor me Nr. 518, datë 13.03.2007, në pronësi të Shoqërisë "LIM-EM" sh.p.k. lënë si garanci hipotekore për Bankën me Kontratë Hipotekore Nr. 1201 Rep., Nr. 809/3 Kol., datë 13.03.2008. Cmimi fillestar i ankandit është 53.424 Euro.

Ankand për pasuritë e mësipërme zhvillohet në datë 11.04.2018. Ankand për pasuritë e mësipërme zhvillohet në ora 16.00, në ambientet e Shoqërisë Përmbarimore "Strati Bailiff's Service", Rruga "Jordan Misja", Pall. 141/1, Shkoqia 1, Ap. 7, Tiranë. Tel: 04 45 00 450, www.stratibailiff.com, info@stratibailiff.com

SHPALLJE (PËR SHITJEN E SENDIT TË PALUAJTSHMË NË ANKAND)

ME DATE 13.04.2018 NGA ORA 8:00 - 16:00, PRANË KESAJ ZYRE PËRMBARIMORE DO TË ZHVILLOHET ANKANDI PËR SHITJEN E APARTAMENTIT ME SIPERFAQE 80.25 M² NR. PASURIE 46/205ND+1-36, ZK 8518, VUI 43 I VENDORUR NË DURRES L. 13 PLAZH, NË PRONËSI TË SHOQËRISË SIAC SH.P.K. CMIMI FILLESTAR PËR ÇELJEN E ANKANDIT TË 1-6 ËSHTE 3.389.760 LEKË.

Te interesur të paraqiten pranë zyrës përmbarimore A.D.R. Përmbarues Gjyqësor Dorian Zazani, në adresën: Durrës, L.nr 2, rr. A.Goga, ose te kontaktojnë ne nr. tel: 0672586883

EMIGRANTËT NË ITALI BASHKIMI FAMILJAR

Beskida Aliaj: Ja 5 kategoritë që mund të aplikojnë për qëndrim në këtë shtet

Kriteret për të përfituar bashkim familjar në Itali

"Dokumentacioni që nevojitet për kandidatët"



Voltiza Duro

Të gjithë ata qytetarë që përmbushin kriteret e përcaktuara mund të aplikojnë për bashkim familjar në Itali. Në një intervistë për "Gazeta Shqiptare", drejtoresha e patronatit INAS Albania, Beskida Aliaj tregon për pesë kategoritë që mund të përfitojnë qëndrim në Itali, falë bashkimit me familjarët e tyre që jetojnë në këtë shtet. Më tej ajo sqaron për të gjithë të interesuarit dokumentacionin që duhet dorëzuar, bazuar në tipologjitë e bashkimit familjar dhe thekson se paraqitja e dokumentacionit të kërkuar nuk sjell domosdoshmërisht lëshimin e vizës.

Cilat janë kriteret për të përfituar bashkim familjar në Itali?

Në bazë të normativës në fuqi, kategoritë e mëposhtme të familjarëve mund të kërkojnë bashkim familjar me qytetarë shqiptarë me qëndrim të rregullt në Itali. Specifikisht bëhet fjalë për këto kategori: bashkëshortë jo të ndarë ligjrisht, me moshë jo më pak se 18 vjeç; fëmijë të mitur, qoftë edhe të bashkëshortit apo të lindur jashtë martese, të pamartuar me kusht që prindi tjetër, nëse ekziston, të ketë dhënë pëlqimin e tij; si dhe fëmijë në moshë madhore në ngarkim, në rast se për arsye objektive nuk janë në gjendje të kujdesen për nevojat e tyre të jetesës për shkak të gjendjes shëndetësore që përbën invaliditet të plotë. Gjithashtu, kanë të drejtë të kërkojnë bashkim familjar edhe prindërit në ngarkim, në rast se nuk kanë fëmijë të tjerë në vendin e origjinës apo prejardhjes; si dhe prindërit mbi 65 vjeç që nuk kanë fëmijë të tjerë në vendin e origjinës apo prejardhjes (ose kur fëmijët e tjerë nuk kanë mundësi të kujdesen për ta për arsye të rënda shëndetësore të dokumentuara).



Drejtoresha e patronatit INAS Albania, Beskida Aliaj

DOKUMENTET

Nënvizohet se paraqitja e dokumentacionit të kërkuar nuk sjell domosdoshmërisht lëshimin e vizës. Të gjitha dokumentet dhe deklaratat në shqip të lëshuara nga autoritetet lokale, duhet të jenë të përkthyer në gjuhën italiane dhe të apostiluara nga Ministria e Jashtme shqiptare.

Cill është dokumentacioni që nevojitet?

Dokumentacioni i nevojshëm për të gjitha tipologjitë e bashkimit familjar përfshin: formularin e kërkesës për vizë (duhet përdorur një formular për secilin aplikant për vizë, i plotësuar në secilin pjesë të tij dhe i firmosur. Në rastin e të miturve, formulari duhet firmosur nga të dy prindërit, (ose kujdestari) pranë Kancelarisë Konsullore; pasaporta e vlefshme (skandencia e pasaportës duhet të jetë të paktën tre muaj pas mbarimit të afatit të vizës që kërkohet); një fotokopje e pasaportës; 2 fotografi të kohëve të fundit të formatit tesar; një certifikatë personale (vetëm nëse është kërkesa e parë për vizë, për të verifikuar përkatësinë territoriale të Kancelarisë Konsullore të Ambasadës së Tiranës). Gjithashtu, duhet dhe një fotokopje e lejes së qëndrimit të vlefshme e qytetarit shqiptar me qëndrim të rregullt në Itali. Në rast se është

e skaduar duhen paraqitur 3 faturat e pagesës për kërkesën për rinovim; dhe një fotokopje e Autorizimit (Nulla Osta) lëshuar nga Sporteli i Vetëm për Emigracionin (SUI). Por ka raste që duhen edhe dokumente shtesë.

Cilat janë më specifikuat dokumentet shtesë që nevojiten në raste të veçanta?

Në varësi të rasteve, duhet shtuar dokumentacioni i mëposhtëm për kërkesat për bashkim familjar nga qytetarë shqiptarë me bashkëshort me qëndrim të rregullt në Itali duhet një certifikatë martesë (vlefshmëria 6 muaj). Ndërsa për kërkesat për bashkim familjar të fëmijëve minorene me prind shqiptar me qëndrim të rregullt në Itali nevojiten: certifikatë e gjendjes familjare; në rastin kur të dy prindërit janë rezident në Itali, fotokopje e lejes së qëndrimit të prindit që nuk kërkon bashkim familjar; në rast se prindi tjetër është rezident në Shqipëri duhet të firmosë një akt pëlqimi për daljen e fëmijës jashtë shtetit, pranë selisë së Kancelarisë Konsullore në momentin e paraqitjes së kërkesës së vizës); në rast se vetëm një prej prindërve ka të drejtën prindërore, dokumentacion që të provojë këtë të drejtë si dhe në rast të bashkimit familjar me fëmijët e bashkëshortes, certifikatë martesë.

Po në rastet e fëmijëve me aftësi të kufizuar apo jetim, cill është dokumentacioni që nevojitet për bashkim familjar?

Për kërkesat për bashkim familjar të fëmijëve në moshë madhore në ngarkim (në kushte invaliditeti të plotë) duhet një certifikatë mjekësore lëshuar nga mjeku i besuar i ambasadës; si dhe një certifikatë e gjendjes familjare. Ndërsa për kërkesat për bashkim familjar të prindërve me fëmijët duhet një certifikatë e gjendjes familjare (trung familjar) me të gjithë fëmijët, me të gjitha shënimet si dhe ndryshimet e mundshme të gjendjes familjare; një fotokopje e dokumentit të qëndrimit; një dokumentacion mbi të ardhurat e përgjithshme nga puna, ose/edhe pronësi ose pensioni (deklaruarë e zyrës lokale të ISSH që vërteton shumën e pensionit të marrë); si dhe një dokumentacion që provon të qenit nën ngarkim të qytetarit shqiptar që ka bërë kërkesën për bashkim familjar (fatura transferimi të parave në kohë për një periudhë prej të paktën 6 muaj para kërkesës për vizë etj.).

Si procedohet në rastet kur do të kryhet kërkesa për bashkim familjar për prindërit?

Për kërkesat për bashkim familjar të prindërve mbi 65 vjeç që nuk kanë fëmijë të tjerë në vendin e origjinës apo të prejardhjes (ose kur fëmijët e tjerë nuk kanë mundësi të kujdesen për ta, për arsye të rënda shëndetësore të dokumentuara) nevojitet një certifikatë e gjendjes familjare me të gjithë fëmijët, me të gjitha shënimet si dhe ndryshimet e mundshme të gjendjes familjare; fotokopje e dokumentit të qëndrimit (nëse është i skaduar edhe 3 faturat e rinovimit të tij) të të gjithë fëmijëve me qëndrim jashtë shtetit (në rast se një apo më shumë se një fëmijë janë me qëndrim të rregullt në një shtet që nuk është Italia, dokumenti në fjalë duhet të jetë i përkthyer dhe legalizuar nga një përfaqësi diplomatike/konsullore italiane në atë vend); si dhe një certifikatë mjekësore lëshuar nga mjeku i besuar i ambasadës, që të vërtetojë se fëmijët me banim në Shqipëri janë në



DOKUMENTACIONI I NEVOJSHËM PËR TË GJITHA TIPOLOGJITË E BASHKIMIT FAMILJAR

- Formulari i kërkesës për vizë (duhet përdorur një formular për secilin aplikant për vizë, i plotësuar në secilin pjesë të tij dhe i firmosur. Në rastin e të miturve, formulari duhet firmosur nga të dy prindërit, (ose kujdestari) pranë Kancelarisë Konsullore);
- Pasaporta e vlefshme (skandencia e pasaportës duhet të jetë të paktën tre muaj pas mbarimit të afatit të vizës që kërkohet);
- Një fotokopje e pasaportës;
- 2 fotografi të kohëve të fundit të formatit tesar;
- Certifikatë personale (vetëm nëse është kërkesa e parë për vizë, për të verifikuar përkatësinë territoriale të Kancelarisë Konsullore të Ambasadës së Tiranës);
- Fotokopje e lejes së qëndrimit të vlefshme e qytetarit shqiptar me qëndrim të rregullt në Itali. Në rast se është e skaduar duhet paraqitur 3 faturat e pagesës për rinovim;
- Fotokopje e Autorizimit (Nulla Osta) lëshuar nga Sporteli i Vetëm për Emigracionin (SUI).

Në varësi të rasteve, duhet shtuar dokumentacioni:

1. Për kërkesat për bashkim familjar nga qytetarë shqiptarë me bashkëshort me qëndrim të rregullt në Itali:
 - a) certifikatë martesë (vlefshmëria 6 muaj);
2. Për kërkesat për bashkim familjar të fëmijëve minorene me prind shqiptar me qëndrim të rregullt në Itali:
 - a) certifikatë e gjendjes familjare;
 - b) në rastin kur të dy prindërit janë rezident në Itali, fotokopje e lejes së qëndrimit të prindit që nuk kërkon bashkim familjar;
 - c) në rast se prindi tjetër është rezident në Shqipëri duhet të firmosë një akt pëlqimi për daljen e fëmijës jashtë shtetit, pranë selisë së Kancelarisë Konsullore në momentin e paraqitjes së kërkesës së vizës);
 - d) në rast se vetëm një prej prindërve ka të drejtën prindërore, dokumentacion që të provojë këtë të drejtë.
 - e) në rast të bashkimit familjar me fëmijët e bashkëshortes, certifikatë martesë.
3. Për kërkesat për bashkim familjar të fëmijëve në moshë madhore në ngarkim (në kushte invaliditeti të plotë):
 - a) certifikatë mjekësore lëshuar nga mjeku i besuar i Ambasadës;
 - b) certifikatë gjendjes familjare

gjendje të rënda shëndetësore të dokumentuar dhe nuk mund të kujdesen për prindërit.

Ku duhet të kenë kujdes aplikantët?

Të gjitha dokumentet dhe deklaratat në shqip të lëshuara nga autoritetet lokale, duhet të jenë të përkthyer në gjuhën italiane dhe të apostiluara nga Ministria e Jashtme shqiptare. Certifikatat e gjendjes civile duhet të jenë të lëshuara nga jo më shumë se 6 muaj. Formularët për kërkesën për vizë dhe modularet në përdorim mund të shkarkohen nga siti i Ambasadës

ëëë.ambtirana.esteri.it (në veçanti konsultoni sektorët "Viza" dhe "Modulistikë") si dhe shpërndahen pa pagesë në mirëpritur në zyrat tona duke e ditur që qëllimi ynë i vetëm është që t'ju ndihmojmë të të zgjidhni problemet tuaja. Mund t'i drejtoheni patronatove INAS CLS Albania, Patronato ACLI dhe ITAL Uil në Tiranë për sqarime të detajuara në lidhje me dokumentacionin dhe projektin.



Foto ilustruese

PROJEKTI

Projekti FORMA vepron nëpërmjet përfshirjes së të gjithë anëtarëve të familjes, jo vetëm të atyre që bëhen gati për t'u larguar, por edhe të aplikantit, duke njohur dhe vlerësuar rolin e tij si protagonist dhe lehtësues i të gjithë rrugëtimit.

KATEGORITË PËRFITUESE

1. Bashkëshortët jo të ndarë ligjërisht, me moshë jo më pak se 18 vjeç;
2. fëmijë të mitur, qoftë edhe të bashkëshortit apo të lindur jashtë martesë, të pamartuar me kusht që prindi tjetër, nëse ekziston, të ketë dhënë pëlqimin e tij;
3. fëmijë në moshë madhore në ngarkim, në rast se për arsye objektive nuk janë në gjendje të kujdesen për nevojat e tyre të jetesës për shkak të gjendjes shëndetësore që përbën invaliditet të plotë;
4. prindër në ngarkim, në rast se nuk kanë fëmijë të tjerë në Vendin e origjinës apo prejardhjes;
5. prindër mbi 65 vjeç që nuk kanë fëmijë të tjerë në Vendin e origjinës apo prejardhjes (ose kur fëmijët e tjerë nuk kanë mundësi të kujdesen për ta për arsye të rënda shëndetësore të dokumentuara).

Aktivitetet dhe shërbimet e ofruara nga projekti FORMA përfshijnë:

- Vënie në dispozicion të hapësirave dhe materialeve të informacionit, duke iu referuar veçanërisht procedurave të aplikimit për vizë, të legjislacionit të përgjithshëm në fushën e të drejtave sociale dhe vlerave që udhëzojnë sjelljet në vendin tone;
- shërbimet e informacionit, asistencë, orientim dhe trajnim përpara nisjes siç janë më poshtë:
- orientimi fillestar për të vlerësuar kompetencat, aftësitë dhe qëndrimet e përgjithshme të subjekteve të përfshira;
- asistencë në menaxhimin e dokumentacionit në lidhje me procedurat e hyrjes;
- trajnimi i gjuhës;
- edukimi qytetar-kulturor;
- organizimi i laboratorëve dhe seminareve për studim më të thellë të temave të trajtuara.
- akses në një platformë online informacioni dhe trajnimi në distancë, i cili lejon përmirësimin e përdorimit dhe përshatjen e përmbajtjes së propozuar.

Drejtoresha e INAS: Përfitojnë fëmijët, bashkëshortët dhe prindërit e shtetasve të huaj

Projekti FORMA, 300 shqiptarë do të përzgjidhen për bashkim familjar

"Synon lehtësimin e procedurave"

Voltiza Duro

Deri në mars të 2019-ës, plot 300 shqiptarë do të kenë mundësinë të bëhen pjesë e projektit FORMA, për të lehtësuar kështu rrugën e tyre drejt bashkimit familjar në Itali. Përfutur të këtij projekti janë fëmijët, bashkëshortët dhe prindërit e shtetasve të huaj që kanë aplikuar për bashkim familjar, ku përfshihet edhe vendi ynë. Drejtoresha e patronatit INAS Albania, Beskida Alija, në një intervistë për "Gazeta Shqiptare" tregon se "FORMA" është rruga e bashkimit familjar për në Itali, e më tej shpëgon se pjesëmarrja e përfuturës në aktivitetet e propozuara paraqet një mundësi të çmuar për të marrë ndihmë të drejtëpërdrejtë në menaxhimin e dokumenteve dhe procedurave të nevojshme për hyrjen në Itali; e për të fituar aftësi qytetare dhe gjuhësore.

Cfarë synon projekti FORMA?

Projekti FORMA synon të kualifikojë dhe të lehtësojë rrugën e bashkimit familjar nëpërmjet trajnimeve para nisjes. FORMA vë në dispozicion të përfuturës një sistem shërbimesh duke i kushtuar vëmendje të veçantë çështjeve të tilla si njohja e gjuhës italiane, kultura qytetare, studimi i trashëgimisë kulturore dhe vlerave të Italisë. Për zbatimin e projektit FORM@ bashkëpunojnë 4 patronët CePa (INCA, INAS, ITAL dhe Patronato ACLI) me INCA CGIL si partner kryesor në partneritet me SHOQATËN GJENERATA E RE ITALO-KINEZE, ANOLF, UNIRAMA S.A.S. dhe Shkollën Ndërkombëtare të Gjuhës.

Cilët janë përfuturët e këtij projekti?

Përfuturët e projektit janë fëmijët, bashkëshortët dhe prindërit e shtetasve të huaj që kanë aplikuar për bashkim familjar nga vendet e mëposhtme: Shqipëria, Kina, Egjipti, Ekuadori, Maroku, Moldavia, Peruja, Senegali, Tunizia dhe Ukraina. Numri i përgjithshëm i përfuturës shkon në mbi 5000 (kujtojmë se nga viti 2011 deri më sot hyrjet për



Foto ilustruese

bashkim familjar janë motivi i parë për hyrjen në vendin tonë). Në Shqipëri do të përfutojnë plot 300 shqiptarë nga ky projekt deri në mars të 2019-ës.

Në cfarë konsiston ekzaktësisht FORMA?

Projekti FORMA vepron nëpërmjet përfshirjes së të gjithë anëtarëve të familjes, jo vetëm të atyre që bëhen gati për t'u larguar, por edhe të aplikantit, duke njohur dhe vlerësuar rolin e tij si protagonist dhe lehtësues i të gjithë rrugëtimit. Gjithashtu, ky projekt vepron duke vënë në dispozicion një sistem shërbimesh, që përfshijnë: informacion, ndihmë në menaxhimin e procedurave të hyrjes, orientim dhe formim qytetarogjuhësor. Më tej operon nëpërmjet nxitjes së proceseve reale dhe të qëndrueshme të integritimit të përfuturës, duke siguruar njohuri dhe kompetenca të dobishme për pjesëmarrjen aktive në jetën shoqërore të vendit tonë, të vetëdijshëm për të drejtat dhe detyrimet e parashikuara nga ligji italian.

Si mund të bëhen pjesë e projektit FORMA të interesuarit?

Rrugëtimi aktivizohet në Itali në momentin kur bëhet kërkesa për autorizim në një nga zyrat territoriale të Patronateve pjesëmarrëse në Projekt. Mjeti që lejon pjesëmarrjen në Projektin FORMA është Marrëveshja e Shërbimit, në të cilën ndahen dhe nënshkruhen objektivat e kësaj ndërhyrjeje, veprimet e programuara dhe angazhimet e marra përsipër nga të gjitha palët.

Cfarë duhet të bëjë specifikisht aplikanti dhe familjarët e tij?

Aplikanti duhet të nënshkruajë Marrëveshjen e Shërbimit, të kontaktojë familjarët e tij për t'i orientuar ata në strukturat e projektit të pranishëm në vende të ndryshme, duke nxitur përfshirjen e tyre në aktivitetet dhe duke mbështetur pjesëmarrjen e tyre në kursin e asistencës, orientimit dhe trajnimit. Ndërkohë familjarët që i bashkohen aplikantit duhet të marrin pjesë në mënyrë aktive në shërbimet dhe iniciativat e planifikuara, si dhe të përdorin platformën e mësimin në distancë që do të vihet në dispozicion për përvetësimin e aftësive qytetarogjuhësore.

Cfarë përfutojnë pjesëmarrësit nga ky program?

Pjesëmarrja e përfuturës në aktivitetet e propozuara paraqet një mundësi të çmuar për të marrë ndihmë të drejtëpërdrejtë në menaxhimin e dokumenteve dhe procedurave të nevojshme për hyrjen në Itali; për të fituar aftësi qytetare dhe gjuhësore, pra që të kuptojnë identitetin, kulturën dhe vlerat e vendit të destinacionit si dhe për të promovuar ato aftësi dhe kompetenca që janë në gjendje të lehtësojnë pajtueshmërinë e angazhimeve të marra me Marrëveshjen e Integritimit pas hyrjes në Itali.

A mund t'i shpjegoni më specifikisht fazat nëpër të cilat do të kalojë ky projekt?

Aktivitetet e planifikuara të projektit janë të ndara në: një fazë e parë përgati-

tore, përmes krijimit të fletëpalosjeve të thelluara të 10 vendeve, objekt i aktiviteteve dhe përpunimit e profilizimit të përfuturës të trajnimit para nisjes. Më tej është një fazë e dytë, në të cilën do të përpunohet materiali informues i një natyre qytetarogjuhësore me mjete me shumë kanale dhe me shumë nivele; si dhe një fazë e tretë që konsiston në marrjen përsipër të më shumë se 5000 përfuturës, që të përdorin shërbimet e planifikuara një fazë e katërt e kthimit të veprimet të projektit, edhe nëpërmjet realizimit të një raporti mbi temën e politikave për sa i përket ribashkimit, duke i kushtuar vëmendje të veçantë përsëritjes dhe qëndrueshmërisë së modeleve të testuara.

A do të kryhet një trajnim gjuhësor për ata që do të bëhen pjesë e projektit?

Trajnimi gjuhësor synon të arrijë një njohuri të parë bazë të gjuhës italiane. Kursi do të zhvillohet përmes një aplikacioni funksional shumëgjuhësh për një mënyrë të mësuarit në distancë dhe, gjithashtu, me 10 orë kurs në zyrën e Patronateve në vendet e origjinës. Brenda kursit të trajnimit do të organizohen testet specifike verifikuese që do t'i lejojnë përdoruesit të ketë qasje të drejtëpërdrejtë në njësitet mësimore, të cilat i përpunohen me mirë nivelit të kompetencave dhe aftësive të secilit. Formimi me karakter qytetar-kulturor do të organizohet sipas katër fushave kryesore tematike.

ARTISTET NE DIKTATURE DOKUMENTET

Dokumenti i '79-s, dy piktorët Nexhat Mujullori dhe Ismail Lulani, informojnë Komitetin Qendror

"Blerim Luzha na tha se Rexhep Ferrin e ka dërguar UDB-ja"

Raporti sekret: "Në kohën e Rankoviçit, ai e kishte mbiemrin Ferroviç"

Dashnor Kaloçi

Në kuadrin e marrëdhënieve të mira dhe deri diku miqësore që mbajti Tirana zyrtare me Jugosllavinë e Marshallit Tito nga fundi i viteve '60-të (pas agresionit ushtarak të Bashkimit Sovjetik ndaj Çekosllovakisë) e deri në fillimin e vitit 1981, kryesisht në planin ekonomik me shkëmbimet tregtare dhe ato kulturore e arsimore, gjatë gjithë asaj dekade, midis dy vendeve pati shkëmbime të shumta delegacionesh, ku mjaft personalitete të artit, kulturës e arimit nga viset shqiptare në Jugosllavi vizituan Shqipërinë dhe anasjelltas. Në këtë kuadër, aty nga mesi i nëntorit të vitit 1979, në Shqipëri erdhën për vizita dhe për të hapur disa ekspozita personale edhe disa piktorë shqiptarë nga Kosova, Mali i Zi dhe Maqedonia, apo dhe disa të tjerë shtetas të këtyre trevave me origjinë sllave, si Vojo Todor dhe Slobodan Bujuriç, titullarë të shoqatave e institucioneve kulturore dhe artistike të Malit të Zi. Ndërsa nga "miqtë" e ardhur nga Kosova, njëri prej tyre ishte dhe Blerim Luzha, piktor mjaft i njohur me origjinë nga Gjakova, i cili gjatë vizitës së tij në Shqipëri, shoqërohej edhe nga babai i tij, Qamil Luzha, veteran dhe atdhetar i njohur, që në periudhën e luftës kishte banuar në qytetin e Tiranës ku kishte dhe shtëpinë e tij. Ashtu siç ndodhte në atë kohë në vizitat e ndërsjella, miqtë artistë nga Kosova, Mali i Zi dhe Maqedonia, kur vinin në Shqipëri shoqëroheshin nga kolegët e tyre nga atdheu amë dhe kjo gjë ndodhte dhe anasjelltas. Në këtë kuadër, piktorin kosovar Blerim Luzha i cili erdhi për të hapur ekspozitën e tij personale në Tiranë, e kanë shoqëruar disa kolegë të tij, personalitete të arteve figurative, si piktorët e njohur: Ismail Lulani, Nexhat Mujullori, Sali Shijaku dhe Qirjako Mëniko. Të cilët pas largimit të "miqtë" të tyre, kanë bërë dhe raport-informacionet përkatëse për Komitetin Qendror, duke dhënë me detaje gjithçka kishin parë, biseduar dhe dëgjuar prej tyre, si dhe takimet e ndryshme që ata kishin pasur edhe me kolegë të tjerë si nga Shqipëria, ashtu dhe nga Kosova, Mali i Zi dhe Maqedonia. Në këtë kontekst, apo më saktë në bazë të "këtyre




Akademiku Rexhep Ferri duke dhuruar portretin e Pjetër Bogdanit të punuar prej tij. Prishtinë 2017

rregullave". Mujullori, Lulani, Shijaku dhe Mëniko, kanë përpiluar edhe raport-informacionet që po i publikojmë për herë të parë në faqet e këtij libri. Ajo që vihet re në raport-informacionet në fjalë, të cilat i kemi shkëputur nga një dosje voluminoze me siglën sekret, janë bisedat e bëra ndërmjet shoqëruesit Nexhat Mujullori dhe Blerim Luzhës, lidhur me takimin e papritur që ata kanë pasur në Hotel "Dajti" me kolegun e tyre, piktorin e njohur nga Kosova, Rexhep Ferri. (Rexhep Ferri, lindur në Kukës në vitin 1937 dhe i diplomuar në degën e Pikturës Monumentale të Akademisë së Arteve të Beogradit në vitin 1966, akademik, poet, romancier, publicist dhe një nga përfaqësuesit më të njohur të trashëgimisë ar-

tistike të Kosovës). Për të cilin, Blerim Luzha ka shprehur hapazi tek kolegët shqiptar rezervat e tija, madje duke aluduar dhe e akuzuar hapur si "njeri i Beogradit" që autoritetet jugosllave, apo më saktë duke lënë të nënkuptohet, UDB-ja, e kishte dërguar në Shqipëri me mision, për të survejuar një kolegun e tij, me mbiemrin Hoxha, për të cilin, piktor Luzha shprehej se "ishte burrë i mirë". Për më shumë lidhur me këtë gjë si dhe vizitat e bëra në Shqipëri nga piktori Blerim Luzha, (aktualisht një nga personalitetet më në zë të arteve figurative të Kosovës), takimet e tija me kolegë e të njohur të tjerë, na njohin dy dokumentet e mëposhtme që po i publikojmë të plota dhe pa asnjë shkurtim.



Blerim Luzha në vitet '70



Ismail Lulani, piktori i njohur shqiptar nga Shkodra

“
Së shpejti libri më i ri, "Shkrimtarët dhe artistët nën diktatin komunist", i gazetarit dhe studiuesit të njohur, Dashnor Kaloçi

INFORMACION


Mbi disa të dhëna nga shoqërimi që i bëme delegacionit Mala Zes

1. Slobodan Bujuriç, President i Lidhjes së Artistëve të Malit të Zi
2. Vojo Tatar, Sekretar i kësaj Lidhje.

Që të dy piktorët të njohur në Mal të Zi, gjithashtu kishin edhe disa tituj më të lartë si piktorë.

U shoqëruan nga Nexhat Mujullori dhe Ismail Lulani nga data 22.XI.1979 deri më datën 28.XI.1979.

Vojo Tatar më tha se në Luftën e Parë, gjyshi i qe vrrarë në Malin e Taraboshit në Shkodër dhe se i jati i babajt të tij kishte marrë pjesë në luftën çlirimtare kundër Gjermanisë me funksion si komandant batalioni, e megjithkëtë tha ai ka vetëm dy vjet që i kanë dhënë shtëpi. Ai vazhdimisht ka kërkuar që të sigurojë plazhin ndonjë vit, atij nuk ja japin mundësinë thoshte Vojo.




Ndërkohë atë e ndërpriste në bisedë Slobodani të cilit i ishin vrrarë dy vëllezër në luftë dhe se nëna e tij ishte aktivizuar si partizane. Slobodani tha se dikur gjyshi i tij ka qenë konsull në Shkodër.

Ata disa herë përmëndnin Krajl Nikollën për të mirë dhe na thanë se pavarësisht se si kanë qenë, ai ka luftuar për mos bashkimin e Malit të Zi me Republikat. Vojo Tatar i tha se para se të vinte në Shqipëri, më thirrën dhe më thanë të kemi kujdes, mbasi në Shqipëri ngado që të shkosh, ke njerëz që të ruajnë, nuk të lënë të lëvizësh, e shumë të tjera si këto dhe kanë ardhur me këtë mendim, por nuk gjeta atë. Dhe propaganda në Shqipëri tha ai është bërë shumë e keqe, këtë e ka bërë shtypi, radioja dhe si kanë mundur. Ne, këto që pamë këtu, du t'ua themi njerëzve tanë dhe kujtëdo.

Duke kaluar nëpër qytetin e Shkodrës ata thanë se likudimi i pasojave të tërmetit këtu ka çuditur botën. Tek ne kanë filluar vetëm disa institucione apo hotele nga duhet të nxjerrin lekët, ndërsa shtëpitë e njerëzve akoma nuk po u bie ndërmend. Ata panë disa stenda ku ishin vendosur fotografitë e shokut Enver Hoxha në vizitën që bëri në Shkodër.

Slobodani tha se është shumë i bukur Enveri dhe kur ka qenë në vizitë në vitin 1946 në Beograd, kudo flitesh për bukurinë e tij. Mbasi u shkëput pak nga shoku i tij, Vojo më tha: "Atje në Mal të Zi unë njoh një njeri që ka fotografiminë e shokut Enver që kanë dalë bashkë në atë kohë, ai akoma e ruan atë". Ne thanë ata kemi simpati për Shqiptarët, mbasi edhe disa tradita apo zakone të mira na ndodhen të përbashkëta, të cilat nuk i gjejmë tek popujt e tjerë: ne kemi shumë dëshirë që të lidhemi me ju për shkëmbimin e ekspozitave të arteve figurative.

Në Hotel "Dajti" unë takova Blerim Luzhën (Shqiptar nga Kosova). Më pyeti se si ja kalojmë me Mala Zesët, unë i thashë shumë mirë, ai më tha se ata të dy nuk janë djem të këqinj, më mirë të rrih një vit me një Mala Zes se sa një ditë me maqedonas (mbasi dy maqedonas ishin →



Piktori i njohur kosovar, Blerim Luzha, me miq e kolegë të tij gjatë një ekspozite personale, Prishtinë 2017

← pak më tutje), kur e pyeta se pse të jetë kështu, më tha se kanë më shumë besë. Ndërkohë po vinte drejt nesh Rexhep Ferri i cili kishte ardhur atë natë, mbasi e pyes Rexhepin se si ishte me shëndet, Blerimi mbas pak kërkoi leje të largohesh. Unë si me shaka i thashë Rexhepit, se nga mbive ti këtu, kjo është një mrekulli, ai më kapi në qafë më puthi dhe më tha: "As vetë se di, vetëm se erdhën e më thanë që nesër do të nisesh për në Shqipëri". Unë e ndërpres dhe i them se do të kesh ardhur me ftesë të Galerisë së Arteve, jo më tha, jam me me Akademinë e Shkencave, por do të aneksohem dhe me Lidhjen e Shkrimtarëve, po shokë të tjerë do të vijin nga Kosova? Jo, më tha ai, edhe mua kur më thanë të vi, më porositën që me marr vesh, se a po shahet Jugosllavia e ndonjë fjalë me ndigju.

- Unë i them, duke qeshur; e ku ke me i ndigju bre Rexhep, pse ksi sendesh na i kemi than hapur, ndaq në shtyp, ndaq në Televizion, po, po, tha ai, ashtu që besa se as vet se di. Ndërkohë zbrisnin kolegët malazezë dhe u përshëndeta me Rexhepin.

- Të nesërmen Blerim Luzha më thotë: "Nexhat, kur kam pa mbramë Rexhepin, unë krejt jam befasu, se nuk e prisnja, mbase unë e di mirë se nga Kosova nuk do të vinte asnjë. (Po përse them unë). Ai e kaloi këtë duke më thënë, se: ti duhet me e marrë me mend se si shkojnë punët atje, veç një gjë po të them, mbasi unë me ty due me fol haptazi: "Kur kena bë kërkeshën në akademi në atë kohë nuk i jepej e drejta asnjërit me nënshtrësi shqiptare në Beograd, vetëm Rexhep Ferri ka mujt me hy. Dhe se në kohën e Rankoviçit ai e ka pas mbiemrin Ferrovich dhe tash atje me disa punë ngatërrohet, nuk di çfarë me than, po me atë shokun tjetër që ka ardhur me mbiemrin Hoxha, unë e njoh se është burrë shumë i mirë. Me siguri ata i kanë vu Rexhepin mbrapa. Unë tha Blerimi kishe qejf me qëndrue dhe për festat, po s'kam si rri se Rexhepi sa herë që po më sheh, po më pyet kur po shkon?"

- Natën e inagurimit të Ekspozitës më njoftuan se nuk duhet të ishin Malazezët atje dhe unë mbasi i shëtita nëpër Tiranë u thashë se do të shkojmë në ekspozitë në ora gjashtë e gjysëm, ndërkohë edhe vizitorët janë rraluar dhe kemi mundësi ta shikojmë më me nge. Slobodani u takua me Rexhep Ferrin në hotel "Dajti", pas pak erdhi tek unë që po rrinim me Vojn dhe i revoltuar na tha: "Kjo nuk është gjë e mirë. Përse neve nuk na dhatë ftesën për inagurimin e ekspozitës, përse na ndatë nga shumë të tjerë të cilët marrin pjesë në të, përse na ofendon, kur ju vetë na fuat për një gjë të tillë. Ç'të keqe ka, tha Slobodani, kur shokët e qeverisë kanë qënë aty ne i respektojmë rregullat, ne nuk erdhëm nga Mali i Zi me revole në xhep, por përkundraz". Të gjithë këto ai i tha shumë i nervozua dhe menjëherë.

(Unë kuptova se të gjitha këto sqarime i mori nga Rexhepi). Ne u thamë se këtu është keqkuptuar mbasi në ekspozitë do të shkojmë nga ora gjashtë. Ata nuk e vazhduan më këtë bisedë. Në darkën e lamtumirës ata thanë fjalë të mira për ditët që kaluan në Shqipëri dhe kërkuan falje për ndonjë shqetësim që mund të kenë sjellë. (Nexhat Mujullori) (Ismail Lulani)

INFORMACION
LIDHUR ME QENDRIMIN E PIKTORIT KOSOVAR BLERIM LUZHA

Blerim Luzha hapi ekspozitë personale me projekte të tekstit. Ai qëndroi në Shqipëri 21 ditë. Në përgjithësi mbeti shumë i kënaqur për gjithçka që ju bë nga prirja në përcjellje.

Nga vizita që bëmë në Durrës ai rastësisht takoi tre kosovarë të cilët shoqëroheshin nga shoku Gani Keçi. Kur u kthye tha se njëri prej tyre ishte Rexhep Zoga, drejtor i Librit të Prishtinës, për të cilin thoshte se është njeri jo i mirë dhe se është i lidhur me organe të tjera në Jugosllavi.

Mbasi bënë vizitën në Muzeun e Luftës në Gjirokastrë dhe Blerimi la përshtypjet e tija në librin e përshtypjeve dhe nuk shënoi em-

rin, babai i tij Qamil Luzha i hoqi vërejtje që të shkruante emrin dhe mbiemrin e plotë të tij dhe të ve-tin.

Blerim i tha se; unë e shkruaj, po mos harro se nesër vjen dhe e sheh Rexhep Zoga. Qemali shahu nëpër dhëmbë e nevrikorur. Blerimi i tha; tash babë nuk duhet vetëm me dru, por dhe me tru.

Qamil Luzha babai i Blerimit bëri disa vizita. Kur i propozoi Blerimi që të shkruante, ai heshti. I ati i tha se duhet të vish e të njihesh me këta njerëz shumë të mirë dhe patriot.


Qamil me Blerimin bënë vizita në shtëpinë e Bijë Vokshit, Bujar Hoxhës, Ajet Haxhishë. Kërkonte të shkonte tek Shaban Brajha dhe në shtëpinë e Karaman Yllit. Gjithashtu takoi me Ali Boletinin.

Qamil Luzha i tha të birit se kishte tapinë e shtëpisë së tij që kishte në lagjen nr.10 në Tiranë. Blerimi i tha; ç'a merresh me kto punë kot. Ai tha se; unë rroj me shpresë dhe se nuk është e largët dita e unë do të kthehem në shtëpinë time. Për këto punë dinë kush me punu, se të jetë për ju të rinjtë, e ke të vështirë me i pru Kosovës ditë të bukura. Kur unë ndërhyra dhe i them se; ku e ke fjalën Axha Qamil, ai m'u përgjigj, eh mor bir fjalën e kam atje ku e kam pas sot e 35 vjet, megjithëse dinari e dollari i kanë amëltu disa njerëz, që janë me kokrra.

Blerimi më tha se e kishte pas të vështirë për të ardhur në këtë ekspozitë, duke i thënë se përse të jetë personale e të mos jetë e për-bashkët dhe se Bajazit Nushi kishte hezituar dhe me vështirësi ja kishte aprovuar.

Në takimin që bëri Blerim Luzha me ambasadorin jugosllav në ambasadë, i kishte thënë Blerimit se ke bërë shumë mirë që ke ardhur në Shqipëri pikërisht në këtë kohë dhe që kishte hapur ekspozitën, mbasi kjo ndihmon në mbarëvajtjen e marrëdhënieve Jugosllavi-Shqipëri. Blerimi më tha se e kishte pritur shumë mirë. Megjithëse ai tha: "Nexhat mos harro që ai është një skile që nuk e ka shokun".

Më tha se kur po vija nga Kosova, më doli në doganë Qamili, ish-



sekretari për artin dhe kulturën pranë ambasadës jugosllave dhe që është burrë shumë i keq.

Blerimi më kërkoi që të lexonte "Vetëadministrimin jugosllav". Mbasi e morri në librarë më tha se e kishte lexuar artikullin e revistës "Ylli", e kërkoi ta lexonte. I ati i tha se e kemi të incizuar në Gjakovë. Ai tha se ky artikull i ka shqetësuar krerët dhe disa që kanë bukën e Serbit. Dhe u përhap fjala sikur paria e Kosovës e ka kërkuar fshehurazi nga Shqipëria për ta nmxjerrë këtë artikull. Kështu bëjnë në shumë raste Maqedonasit tek Bullgarët ta ai.

Menjëherë mbas këtij artikulli u zhvillua një simpozium, për të parë dhe ndihmuar ato republika të pa zhvilluara dhe konkretisht Kosovën. Kjo tregoi tha Blerimi se artikulli bëri punën e vet.

Mbasi lexoi "Vetëadministrimin Jugosllav" tha se është një gjë shumë interesante dhe të çel sytë. Unë e di tha ai se vetëm në Beograd janë 6.000 mjekë me shkollë të lartë që nuk u sigurohet vëndi i punës.

Kërkoj të merre me vete këto libra:

1. Shënime për Kinën. 2. Vetëadministrimi Jugosllav. Imperializmi dhe Revolucioni, si dhe disa romane të kohës.

Kërkoj që lejen e kufirit t'ja nxirrin nga Kapshtica për të dalë në Greqi mbasi unë e kishte të mundur që të nxirrte librat, pastaj t'i linte tek një mik i tij në Greqi dhe i merre më vonë. Kjo nuk u realizua.

Një ditë më thotë, Nexhat, dua me të thënë diçka: "Kam vue re se nuk afrohen shokët me ardh e me mi" takue, nuk e diç pse ndodh kështu?"

I thamë se ke takuar mjaft shokë si piktorë dhe skulptorë, goftë në hapjen e ekspozitës dhe më vonë si edhe në mbyllje, edhe ditën e largimit disa prej tyre erdhën e të përcollën. Ti na tha se ai Mumtaz Dhrami është në Vlorë, kurse unë e pashë atë. Sali Shijaku erdhi vetëm natën e diskutimit. Unë i thashë mos harro se ata janë në pragun e dy ekspozitave dhe janë në kulmin e punës e megjithatë atë erdhën, ndërsa Mumtazi mundet të ketë ardhur nga Vlorë për punë dhe prapë të ketë ikur mbasi po merret me monumentin e Drashovicës.

Blerimi mendon të kthehet përsëri nga muaji tetor, për të marrë ekspozitën.

Shoqëruesisht
(Nexhat Mujullori (Qirjako Mëniko)

Beratasi Petraq Selamaj kreu i grupit kriminal. Ja si u kap në Leçe në vitin 2012

Sekuestrohen 630 kg kanabis pluhur dhe çokollatë, arrestohen 6 persona

VLORE

Një sasi prej afro 630 kg kanabis sativa është sekuestruar në Orikum gjatë një operacioni antidrogë të zhvilluar nga policia e Vlorës, ndërsa kanë përfunduar në pranga 6 persona. Burime zyrtare nga dikasteri i Rendit dje bënë me dije se operacioni i koduar "SEA" u zhvillua në orët e para të mëngjesit të së dielës në bashkëpunim me Policinë Kufitare Vlorë, Delta Forcë dhe Roja Bregdetare, në bazë të informacioneve të siguruar në rrugë operative. Mësohet se në këtë operacion morën pjesë 40 forca policie. Burimet e më sipërme sqaruan se kanë përfunduar në pranga shtetasit. Sipas policisë së Vlorës, personat e dyshuar si posedues të lëndës narkotike janë: Mario Brahim, 24 vjeç; Berdo Rruçaj, 34 vjeç dhe Halil Kushta, 24 vjeç, të tre banues në Orikum. Ata u kapën në flagrancë në vendin e quajtur Pasha Liman, duke transportuar me automjetet lëndën narkotike, me qëllim trafikimin e saj. Ndërkaq, tre të arrestuarit e tjerë janë: Petraq Selamaj, 40 vjeç; Aleks Duraj, 35 vjeç dhe Erjon Belaj, 28 vjeç. Këta tre të fundit u prangosën në Sazan me mjetin lundrues tip gomone, me të cilin do të kryenin trafikimin e lëndës narkotike. Gjatë operacionit është sekuestruar 629.5 kg kanabis sativa në formë pluhuri; 6.9 kg kanabis në formë çokollate; 900 gr vaj hashash; një gomone, e cila do transportonte drogën drejt Italisë si dhe 5 automjete.

OPERACIONI

Pas një informacioni të marrë në rrugë operative, forcat policore kanë gjetur në bregdetin e Orikumit një furgon, i cili ishte i ngarkuar me disa thasë me kanabis sativa. Një pjesë e tyre kanë qenë në breg të detit gati për t'u ngarkuar për në mjetin tip gomone, i cili gjendej, gjithashtu, në breg të detit. Mbi disa pako kishte disa kode dhe inicialet, të cilat dyshohet të jenë kodet e porositësve të lëndës narkotike. Materialet hetimore në ngarkim të personave të mësipërm do t'i referohen Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Vlorë për veprën penale "Trafikimi i narkotikëve". Në mes personave të arrestuar gjatë operacionit të koduar "SEA" është dhe Petraq Selmanaj, i cili dyshohet të jetë koka e grupit kriminal që trafikonte kanabis. Ai nuk është një emër i panjohur të



Operacioni antidrogë në Vlorë



Një prej të arrestuarve gjatë operacionit

paktën për autoritetet italiane. I lindur në Berat dhe banues në Vlorë, 40-vjeçari është arrestuar dhe më

herët për trafik droge. Më 26 dhjetor të vitit 2012 (një ditë pas Krishtlindjeve), ai do të ndalohej nga policia e

Leçes, ndërsa drejtonte gomonen plot me kanabis. Për më shumë se 4 orë, në atë kohë, policia sekuestroi gomonen me 415 kg marijuanë me vlerë rreth 2 milionë euro. Ishte vetëm ai, Petraq Selamaj, i cili u mbajt nën vëzhgim nga deti dhe ajri. Pasi arriti në breg ai dorëzoi çantat tek njerëzit e tjerë që e prisnin. Pavarësisht se

kishte një numër të madhe efektivësh në terren, policia italiane nuk mundi të arrestonte dot drejtuesin dhe një pasagjer të furgonit, ku u ngarkua lënda narkotike. Ndërsa, dje, në ditën e Pashkëve Katolike, 40-vjeçari Selamaj kishte zgjedhur të niste gomonen nga bregdeti i jugut drejt Italisë. Por këtë herë u bllokua nga autoritetet shqiptare.

PERSONAT E ARRESTUAR NË VLORE

1. Mario Brahim, 24 vjeç, banues në Orikum,
2. Berdo Rruçaj, 34 vjeç, banues në Orikum,
3. Halil Kushta, 24 vjeç, banues në Orikum.
4. Petraq Selamaj, 40 vjeç, banues në Vlorë,
5. Aleks Duraj, 35 vjeç, banues në Llakatund, Vlorë,
6. Erjon Belaj, 28 vjeç, banues në Vlorë.

Akuzohet për "Trafikim i veprave të artit dhe kulturës"

Transportonte bizhuteri antike kontrabandë, 31-vjeçari nga Tirana prangoset në Kakavijë

GJIROKASTËR - Një

31-vjeçar ka rënë në pranga, pasi u kap në pikën kufitare të Kapshticës tek- sa transportonte sende të ndryshme antike. Bëhet fjalë për shtetasin Petrit A., banues në Tiranë. Shërbimet e Policisë Kufitare të Kakavijës, gjatë patrullimit në kufirin jeshil, kanë konstatuar dhe kapur në flagrancë një shtetas, i cili po tentonte të hynte në territorin shqiptar në mënyrë të paligjshme. "Gjatë kontrollit fizik të bërë këtyrë shtetasi, shërbimet e Policisë Kufitare, kanë konstatuar se në çantën e krahut kish-



te sende të ndryshme antike prej metali, argjendi e bronzi. Menjëherë blutë

kanë njoftuar specialistët e seksionit për hetimin e trafikeve në Drejtorinë Ven-

dore të Policisë Gjyrokastër, të cilët në përfundim të veprimeve të para hetimore kanë bërë arrestimin në flagrancë të Petrit A., banues në Tiranë. Në cilësinë e provës materiale u sekuestrua çanta me sendet e ndryshme antike", thuhet në njoftimin e policisë. Ndërkaq, materialet në ngarkim të 31-vjeçarit i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Gjyrokastër për veprat penale: "Kalimi i paligjshëm i kufirit" dhe "Trafikimi i veprave të artit dhe kulturës".

Ishte kthyer në tmerrin e banorëve, kapet autori i një sërë grabitjesh

SARANDË - Autori i një sërë grabitjesh në qytetin e Sarandës është vënë në pranga dy ditë më parë, ndërsa është shpallur në kërkim një shtetas tjetër. Mësohet se 19-vjeçari Shadin Abazi, banues në Sarandë, ishte kthyer në tmerrin e banorëve dhe biznesve të zonës. Sipas policisë, Abazi ishte person i shpallur në kërkim për grabitjen me armë të dy karburanteve në Sarandë dhe për një sërë vjedhjesh nëpër markete e dyqane, por edhe për vjedhje motorësh. I riu po tentonte të largohej nga Saranda, me autobus drejt Tiranës, në momentin e arrestimit. Pas informacionit të marrë, policia e Sarandës është vënë në ndjekje të autobusit dhe e ka arritur atë në aksin nacional Sarandë-Gjyrokastër. Sakaq, është shpallur në kërkim shtetasi I.K., 25 vjeç, banues në Sarandë. Burime policore thanë se ka dokumentuar një seri vjedhjesh të kryera prej këtyrë shtetasve në qytetin e Sarandës, dhe konkretisht: Më datë 15.10.2017, në lagjen "Nr.4.", kanë vjedhur kioskën e shtetasit K.T. Më datë 15.12.2017, në lagjen "Nr.4.", kanë vjedhur motorin e mjetit lundrues të shtetasit M.Ç.. Më datë 22.12.2017, në lagjen "Nr.3.", kanë vjedhur marketin e shtetasit S.H. Më datë 28.12.2017, në lagjen "Nr.1.", kanë vjedhur me dhunë dy pika karburanti. Më datë 12.01.2018, në lagjen "Nr.3.", kanë vjedhur marketin e shtetasit A.S. Më datë 29.12.2017, dyshohet se kanë vjedhur motoçikletën e shtetasit K.C.. Më datë 20.02.2018, dyshohet se kanë vjedhur motoçikletën e shtetasit E.C.. Më datë 06.01.2018, dyshohet se kanë kryer vjedhjen me armë të ngelur në tentativë të shtetasit J.C.. Policia e Sarandës vijon punën për zbardhjen e dokumentimit e të tjera vjedhjeve si dhe vënien para përgjegjësisë ligjore shtetasit që kryejnë veprimtari kriminale.



MJEKU POPULLOR



Ylli Merja:
Dieta ushqimore
për trajtimin e
kolesterolit të lartë


TRAJTIMI I PROBLEMIT



Këshilla
praktike për
parandalimin
e variceve

Migena Kika:



Mjekja 
neuropediatre:
Sindroma
"Shaken Baby",
dëmtime të
rënda në
tru e shtyllë
kurrizore

Abuzimi fizik me fëmijët, mund të çojë deri në vdekje

"Kapja e fëmijës nga supet dhe tundja, shkaktarë kryesorë"

• Fruta e vallzës, kuruesi i dhimbjeve të stomakut. Konsumoni çajin e pelinit kundër viruseve e kancerit

Mjekja neuropediatre: Sindroma "Shaken Baby", dëmtime të rënda në tru e shtyllë kurrizore

Migena Kika:

Abuzimi fizik me fëmijët, mund të çojë deri në vdekje

"Kapja e fëmijës nga supet dhe tundja, shkaktarë kryesorë"

Voltiza Duro

Sindroma Shaken Baby, njihet si një formë abuzimi fizik me fëmijën e renditet si faktori i dytë që ndikon në vdekjen e foshnjave nën moshën 1-vjeçare. Në të gjitha rastet kur mund të ndodhë që të kapim fëmijët nga supet apo t'i tundim ata, koka do të kryejë lëvizje rrotulluese që mund të ketë pasojat e këtyre lëvizjeve të shpejta të rënda për shëndetin e të vegjëlve. Në një intervistë për suplementin "Life Pages" në "Gazeta Shqiptare", mjekja neuropediatre, njëkohësisht drejtoreshë në Qendrën për Mirërritjen, Zhvillimin dhe Rehabilitimin e Fëmijëve, Migena Kika tregon se gjatë shkudjes, truri i bebës mund të pësojë dëmtime të rënda, e po ashtu edhe shtylla kurrizore. Sipas mjekes duhet një forcë e madhe për të prodhuar dëmtim të trurit, çka mund të vijë pas një episodi të vetëm ose pas abuzimeve të përsëritura.

Çfarë është trauma abuzive e kokës te fëmijët?

Termi shaken baby syndrome (SBS, sindroma e bebës së shkundur) është një formë abuzimi fizik me fëmijën dhe përbën shkakun e dytë të vdekjeve në fëmijët nën moshën 1 vjeç, pas sindromës së vdekjes së papritur tek fëmijët.

Cilat janë disa nga faktorët që ndikojnë në shfaqjen e kësaj sindrome?

Kapja e fëmijës nga supet dhe tundja e shkudja e tij

bën që koka të ndërmarrë lëvizje rrotulluese. Efektet e këtij abuzimi janë më të rënda tek fëmijët, sepse koka është më e madhe dhe muskujt e qafës janë më të dobët.

Mund të na tregoni disa nga pasojat që shkakton ky lloj abuzimi?

Kjo lloj tronditje që pëson truri gjatë shkudjes së bebës shkakton dëmtim të rëndë të tij, por mund të kemi edhe dëmtim të shtyllës kurrizore. Në raste të rënda efektet kombinohen me encefalopati ishemike hipoksike. Ndërkohë që thjesht tundja është e mjaftueshme për të shkaktuar dëmtim, në shumë raste kemi kombinim të tundjes me traumën ose vetëm efektin e traumës dhe termi "sindroma tundje-efekt- traumë, shaking-impact syndrome" është përdorur nga disa autorë.

Si ndodh procesi i dëmtimit të trurit te fëmijët?

Akademia Amerikane e Pediatriisë rekomandon termin traume abuzive e kokës (abusive head trauma, AHT) që i përmbledh të dy efektet si tund-

jen e kokës, ashtu dhe ndikimin e traumës. Prandaj termi sindroma e bebës së shkundur shihet si pjesë përbërëse e AHT. Sindroma e bebës së shkundur nuk ndodh pas dëmtimeve insinjifikante apo manipulimeve të përditshme me bebën. Duhet një forcë e madhe për të prodhuar dëmtim të trurit. Mund të vijë pas një episodi të vetëm ose pas abuzimeve të përsëritura.

Si bëhet diagnostikimi i sindromës "Shaken Baby"?

Bebet me sindromën e bebës së shkundur zakonisht cohen në urgjencë me shenja klinike jospecifike si hipotonia, të vjella, janë si të hutuar, të irrituar dhe letargjikë dhe këto shenja mund të ngatërrohen me çrregullime të tjera. Një pjesë e madhe janë apneike dhe komatoze ose



Mjekja neuropediatre Migena Kika

paraqiten në gjendje të vdekur që në lindje. Të mbijetuarit mund të kenë dëmtime trunore permanente. Diagnoza është e vështirë të bëhet vetëm nëse bëhet një ekzaminim fundoskopik dhe një survejim i hollësishëm. Sindroma e bebës së shkundur karakterizohet nga një triadë që përfshin encefalopatisë, hematomat subdurale dhe hemorragjinë retinale. Hematomat subdurale janë të lokalizuara në fisurën interhemisferike ose mbi konveksitetet dhe mund të ndryshojnë në varësi të moshës. Ato janë zakonisht të vogla fillimisht, por mund të zmadhohen më vonë ose të bëhen të dukshme hematoma të tjera „kur truri atrofizohet në fëmijët që mbijetojnë.

Cilat janë treguesit për të kuptuar që një fëmijë ka pasur një abuzim të tillë?

Fëmijët me sindromën e bebës së shkundur kanë zakonisht dhe fraktura në brinjë, kafkë dhe fraktura të tjera, dëmtime në lëkurë dhe inde të buta, dëmtime të

brendshme dhe shenja të tjera të traumës. Hemorragjitë retinale shpesh të mëdha dhe konfluente janë një komponent i rëndësishëm i sindromës së bebës së shkundur dhe kanë korrelacion me gravitetin e dëmtimeve në tru. Mendohet që shkaktohen nga tundja e trupit vitreo që tërheq retinën dhe çan vazat e saj delikate. Dokumentimi i hemorragjisë retinale me ekzaminim fundoskopik është një vlerësim klinik i rëndësishëm i sindromës së bebës së shkundur. Hemorragjitë retinale janë të pazakonta në dëmtimet aksidentale të trurit dhe shihen, por me frekuencë jo të lartë në pacientë me çrregullime hemorragjike, angiopati, sepsis, dhe në situata të tjera jotraumatike.

Në cilat raste jeta e foshnjës mund të vihet në rrezik?

Encefalopatia dhe vdekja vjen si rezultat i EHI- patologjia kyçe në sindromën e bebës së shkundur, si dhe nga rritja e presionit intrakranial. Lëvizja nga njëra anë në tjetrën e kokës gjatë tundjes shkakton një stres të fortë në funksionin kraniocervikal dhe në pjesën e poshtme të trutit të trurit. Në rastet ekstreme palca e kurrizit mund të ndahet nga trunget e trurit. Nëse ushtrohen forca të mëdha mund të dëmtohet funksioni i qendrave vitale në trunget e trurit duke shkaktuar apne centrale. Edema cerebrale që shfaqet gjatë rritjes së presionit intrakranial dhe rëndon situatën e EHI. Dëmtimet e qarjet vasculare nga tundja shkaktojnë hemorragji parenkimale mikroskopike ose më të mëdha. Infarktet e përhapura në mënyrë të çrregullt janë të zakonshme. Këto lëzime i shtojnë deficitet neurologjike dhe rrisin më tej presionin intrakranial.



Voltiza Duro

Kur jeta e individit pas moshës 50 vjeçare ka ardhur e shoqëruar me kolesterol të lartë, çregullime të tensionit, apo diabet, duhet të tregohet një kujdes tejet i veçantë e një ushqyerje e shëndetshme. Dieta ushqimore për këtë kategori njerëzish (vuajnë nga diabeti e kolesterolit lartë) është hapi i parë për një jetesë sa më të shëndetshme. Gjithashtu, dinamika e tyre e lëvizjes ndihmon në zvogëlimin e patologjive të ndryshme, e organizmi i këtyre personave ka nevojë për një strukturë ushqimore të pasur me proteina, vitamina, kripëra minerale, karbohidrate e yndyra; të gjitha këto bazë për një jetë sa më vitale. Vlen të theksohet fakti se këta njerëz në dietën e tyre duhet të marrin më pak karbohidrate, e më pak yndyra shtazore. Komponent kryesor të kjo dietë, duhet të jetë energjia ku duhet të llogarisim koeficientin kalori, në përshatje me moshën ku ky raport kalori/ (pjesëtim) peshë mos e kalojë vlerën 43.

Dieta ushqimore

Në rastet kur koeficienti është më i lartë, duhet të mos konsumohen ushqime të caktuara, në mënyrë që organizmi të konsumojë yndyrat e grumbulluara (dhjami e vetë) për energjinë ditore që i nevojitet. Në këtë mënyrë ne realizojmë jo vetëm një jetë aktive dhe dinamike por bëjmë të mundur që një pjesë e kolesterolit të lartë që është depozituar në organizëm, të kalojë në energji ditore dhe në ujë. Nëse një person ka një peshë trupore 80 kilogram dhe merr afërsisht 2800 kalori në ditë, atëherë kryejmë llogaritë e mëposhtme: 2800/80=35. Pra koeficienti nuk e kalon vlerën 43 dhe ky person është normal. Nga kjo normë ditore, individi duhet të ulë rreth 300 kalori në ditë, pra të mos marrë më 2800 por vetëm 2500 kalori brenda 24 orarshit. Kështu këto 300 kalori, organizmi do i marrë nga vetë kolesterolit i grumbulluar në organizëm. Pasi u përcaktuan këto kritere, në studim u morën dy grupe njerëzish: persona me kolesterol dhe trigliceride të larta; si dhe personat diabetik që kishin kolesterolin e trigliceridet në norma të larta. Në strukturën ushqimore të grupit të parë, pra të individit që vuani nga kolesterolit i lartë, u vendos të përdorej kuzhina mesdhetare e gërshetuar me çajra bimorë dhe tërshërë; të pasura këto me fibra ushqimore. Këta persona duhet të marrin për mëngjes 250 ml qumësht ose kos, 3-4 lugë gjelle me tërshërë, gjysmë lugë çaji me mjaltë dhe gjysmë lugë kafeje me kanellë. Gjithashtu, kjo shoqërohej me një lugë gjelle me boronicë, e pas buke pacientëve iu jepej një gotë çaj për shkrirjen e yndyrave në gjak. Në përbërjen e këtij çaji u kombinuan bimë me fruta pylli,



Mjeku popullor: Sa më shumë proteina, vitamina, kripëra minerale e aktivitet fizik

YLLI MERJA: Dieta ushqimore për trajtimin e kolesterolit të lartë

"Çfarë duhet të konsumoni kur vuani nga diabeti"



Mjeku popullor, Ylli Merja

Dieta ushqimore për këtë kategori njerëzish (vuajnë nga diabeti e kolesterolit lartë) është hapi i parë për një jetesë sa më të shëndetshme. Gjithashtu, dinamika e tyre e lëvizjes ndihmon në zvogëlimin e patologjive të ndryshme, e organizmi i këtyre personave ka nevojë për një strukturë ushqimore të pasur me proteina, vitamina, kripëra minerale, karbohidrate e yndyra; të gjitha këto bazë për një jetë sa më vitale.

lëvore shelgu, lulja dhe fruta i murrizit si dhe çaji i gjelbër. Gjatë studimit u konstatua që këta persona deri rreth orës 14.00-15.00 nuk kishin ndjenjë urie pasi fibrat natyrore që ata konsumuan, ngopnin organizmin. Ndërsa kanella me disa përbërës frenonin thithjen e yndyrave të tepërta e çaji shkrinte yndyrat e ndihmonte që një pjesë e triglicerideve dhe kolesterolit, të shkrihej dhe të kalonte për energji ditore. Pas mëngjesit, rreth orës 11.00, këtyre personave iu rekomandua konsumimi i një molle apo kivi, e më tej një drekë të pasur me perime e zarzavate, shoqëruar me 100 gram mish viçi ose pule. Pas buke, duhej të pinin patjetër një gotë çaj për uljen e kolesterolit si dhe të

konsumonin vetëm 1 fetë buke në mëngjes, 1 në drekë e 1 në darkë. Gjithashtu, këshillohet që në darkë të konsumohet kos

dhe pilaf. Pas kësaj diete, pacientët tregonin se ndiheshin shumë të lehtësuar dhe kishin më energji, e pasi kryen anali-



zat e gjakut, u konstatuan përmirësime të dukshme, ku vlerat e kolesterolit ishin ulur, e po ashtu dhe një normalizim të tensionit pas tre javësh trajtim me këtë dietë ushqimore. Ndërkaq, personat që vuajnë edhe nga diabeti, edhe nga kolesterolit i lartë këshillohet që të përdorin 2-3 herë në javë gjellë me bamje, ose çdo mbrëmje të hidhnin në një gotë me ujë 4 bamje dhe mollë të egra, çaj i cili do të konsumohet në mëngjes. Edhe në këtë rast mëngjesi është kos me tërshërë, por e shoqëruar me kanellë edhe boronicë. Pas mëngjesit këshillohet një çaj antidiabetik, por që njëkohësisht ul dhe kolesterolin e lartë. Pas kësaj konstatuam një rënie të glicemisë dhe normalizim të tensionit.



Varicet janë enë gjaku të mëdha me ngjyrë të errët, të cilat përveçse nuk ju lejojnë të ekspozoni këmbët me fustane, janë të rrezikshme edhe për shëndetin. Edhe vetë mjekët, shpesh japin këshilla në lidhje me trajtimin e këtij problemi dhe zakonisht rekomandojnë disa ndryshime në stilin e jetesës. Nëse kjo metodë dështon, atëherë bëhen ndërhyrje me lazer ose radiofrekuencë. Por, këto procedura, përveçse jo të lira në cmim, mbartin me vete edhe një farë risku. Më poshtë po japim disa këshilla të thjeshta, por shumë të vlefshme për të parandaluar shfaqjen e variceve.

Ruani një peshë ideale

Mbipeshë ose obeziteti tek gratë, i bën ato më të prirura për të shfaqur vena varikoze, sepse kilet e tepërta ushtrojnë peshë mbi këmbët duke parandaluar qarkullimin normal të gjakut. Ruajtja e një peshe ideale nuk lejon shfaqjen e variceve në këmbë.

Konsumoni ushqime të pasura me fibra

Një dietë e lartë në fibra parandalon kapsllëkun. Por a e dini që diçka e tillë zvogëlon edhe riskun e shfaqjes së venave varikoze? Kjo për shkak të vetive të fibrave për të përmirësuar qarkullimin nuk lejon grumbullimin e gjakut në zona të caktuara të enëve të gjakut.

Reduktoni sasinë e kripës

Konsumimi i ushqimeve me shumë kripë ndikon negativisht në presionin e gjakut. Kur presioni i gjakut është i lartë, nuk është në rrezik vetëm zemra, por edhe këmbët tuaja. Limitoni sasinë e kripës në ushqimet tuaja për të mbajtur presionin e gjakut nën kontroll, në të mirë të zemrës suaj dhe venave varikoze.

Lini duhanin

Nëse nuk doni që këmbët tuaja të përfundojnë me varice, ndaloni pirjen e duhanit pasi ky ves ka ndikim negativ në qarkullimin e gjakut dhe enët e gjakut, duke rritur riskun për vena varikoze.

Bëni ushtrime rregullisht

Vrapë dhe ecja duhet të jenë pjesë e pandashme e rutinës suaj, sepse rregullojnë qarkullimin dhe reduktojnë shanset e shfaqjes së venave varikoze që

Këshilla praktike për parandalimin e variceve



në gjymtyrët e poshtme.

Ndërroni këpucët

Nëse jeni mësuar me taka, por nuk doni që në këmbët tuaja të shfaqen ato vena varikoze të tmerrshme, vishni këpucë me takë të ulët. Ato janë të vetmet që mund të reduktojnë njollat e padëshiruara në këmbë dhe në të njëjtën kohë, qetësojnë muskujt e këmbëve, duke e mbajtur qarkullimin solid.

janë më pranë jush se ç'e mendoni. Kështu që përpiquni që një pjesë të kohës suaj t'ia kushtoni ushtrimeve fizike.

Shmangni të qëndruarit në këmbë për orë të gjata

Të qëndruarit në këmbë për periudha të gjata kohe, shkakton presion tek këmbët duke rritur riskun e shfaqjes së venave varikoze. Nëse puna juaj ju kërkon të rri në këmbë, ndryshoni pozicionin herë pas here. Bëni ecje të shkurtra herë pas here në mënyrë që të qarkullojë gjaku në ekstremitetet e poshtme.

Uluni si duhet

Të kryqëzosh këmbët mund të

duket shumë seksi, por kjo gjë rrit mundësinë për t'u prekur nga shfaqja e venave varikoze, të cilat nuk janë dhe aq tërheqëse. Sa herë keni mundësi të uleni, kujdesuni të ruani pozicionin e duhur. Nëse është e mundur, ngrijini këmbët për të reduktuar presionin në to.

Vishni çorape kompresuese

Të tilla çorape mund t'i gjeni në treg. Ato kanë llastik dhe lejojnë qarkullimin e gjakut



Këshilla

Konsumoni çajin e pelinit kundër viruseve e kancerit

Bima e Pelinit e njohur edhe si bima e Artemisias haset në gjendje të egër edhe në Shqipëri. Ajo ka gjetur përdorim të gjerë në mjekësinë tradicionale, ndërkohë që çajrat e përgatitur nga gjethet e thara të kësaj bime janë përdorur për trajtimin e temperaturës. Kjo bimë ka një shije të hidhur, megjithatë vlerat e saj shëndetësore janë të fuqishme.

Disa prej studimeve më të fundit kanë zbuluar se kjo bimë përmban një substancë të njohur si artemisinin, e cila parandalon zhvillimin e një sërë virusesh përfshirë herpesin, apo hepatitin B dhe C. Shkencëtarët janë, gjithashtu, të angazhuar në studimin e një substance tjetër të kësaj bime të njohur si 'thujon' që rezultoi të jetë antioksidant shumë i fuqishëm. Ekstraktet e kësaj bime përdoren për uljen e temperaturës dhe për fuqizimin e sistemit imunitar. Së fundmi, aftësitë qetësuese të këtyre ekstrakteve janë përdorur edhe në terapi të shumta aromash. Pelini përdoret, gjithashtu, edhe në industrinë e parfumerisë dhe për shumëfishimin e shijes dhe aromave të pijeve dhe verërave.



Ndërkaq, disa studime të tjera kanë zbuluar lidhje mes dy prej substancave përbërëse të kësaj bime: artemisinina dhe artesunate në luftën kundër kancerit. Kjo bimë ka potencial të fortë në trajtimet terapeutike dhe parandaluese kundër tumoreve. Çaji i Pe-

lini apo Artemisias është një kurë tradicionale bimore që mendohet të përmirësojë sistemin imunitar dhe të qetësojë mendjen. Në shumë raste, çajrat e tillë konsumohen nga njerëzit që zgjedhin kurat bimore në vend të pilulave farmaceutike.



Fruta e vallzës, kuruesi i dhimbjeve të stomakut

Vallzat, emri botanik i të cilave është *Sorbus aucuparia*, janë fruta kokërr vogla të cilat rriten kryesisht në male e kodra. Kjo frutë është e rrallë për pjesë më të madhe të botës. Më shumë e përhapur është në zonën e Ballkanit, përfshirë edhe Shqipërinë, Amerikën e Veriut si dhe Azinë Veriore gjithashtu. Vallzat rriten në klimë të ftohtë ndaj dhe karakteristikë e tyre është rritja në zonat malore. Këto fruta kokrra të vogla janë të paketuara me një numër të lartë vlerash ushqyese. Përfshirë këtu një nivel të lartë të vitaminës C, fibra ndërsa cilësohen, gjithashtu, si të çmuara për vetitë e tyre antioksiduese.

Falë nivelit të lartë të vitaminës C, vallzat ndihmojnë në forcimin e imunitetit. Përfshirë këtu edhe përmirësimin e nivelit të kolagjenit, i cili ndihmon në forcimin e muskujve dhe ndihmon në mirëfunksionimin e enëve të gjakut. Këto fruta janë fantastike për sa i përket aktivitetit të tyre antibakterial. Acidi sorbik tek këto fruta ndihmon në eliminimin e bakteveve dhe mikrobeve që prekin lëkurën dhe trupin gjithashtu. Vallzat kanë, gjithashtu, veti shumë të mira për sa i përket ndikimit të tyre në mirëfunksionimin e sistemit të tretjes. Çaji i vallzave të thara është përdorur që në lashtësi për të kuruar dhimbje e barkut, diarrenë si dhe dhimbjet e stomakut. Sot, vallzat nuk gjenden lehtë në treg ato janë përherë pjesë e sasive të vogla me fruta që shiten në tregjet e fshatarëve.



Agjencia e Trajtitimit të Pronave: Përfituesit kanë edhe 4 muaj kohë për të plotësuar dokumentet

Ornela Manjani

Agjencia e Trajtitimit të Pronave ka përfunduar procesin e vlerësimit financiar të vendimeve përfundimtare për dosjet e vitit 1997, të cilat kanë njohur të drejtën e kompensimit të subjekteve të shpronësuar në të gjithë vendin. Në përfundim të procesit të verifikimit të vendimeve të administruara pranë arkivës së ATP-së, u identifikuan gjithsej 1462 vendime të vitit 1997, të cilat kanë njohur të drejtën e kompensimit të subjekteve të shpronësuar, sipërfaqja e njohur për kompensim, vlerësimi financiar përkatës apo mangësitë në dokumentacion dhe problematikat në vlerësim jepen të detajuara për çdo dosje. Numri total i vendimeve të viteve 1993-1997, që kanë njohur të drejtën e kompensimit të subjekteve të shpronësuar

Lista VI/ Vendimet e vitit 1997, emrat e 1462 pronarëve që kompensohen

Kanë njohur të drejtën e kompensimit për vitet 1993-1997 rreth 17 318 vendime

dhe që janë vlerësuar financiarisht e publikuar nga ATP-ja është 17 318 vendime. "Gazeta Shqiptare" publikon listën e plotë me përfituesit e vitit 1997 së bashku me vlerën financiare.

MUNGESA E DOKUMENTACIONIT

Sipas ATP-së, në rastet kur subjektet e interesuara nuk sjellin dokumentacion të nevojshëm për vlerësimin financiar të vendimit të kompensimit brenda afatit 6-mujor nga data e publikimit të regjistrit, si dhe në rastet

kur ATP-ja është në pamundësi objektive për të vlerësuar pronën, bazuar në dokumentacionin që disponon vendimi i kompensimit vlerësohet financiarisht. Pronarët kanë edhe 4 muaj kohë për plotësimin e dokumenteve dhe ATP njofton të gjitha subjektet, që për çdo informacion apo paqartësi lidhur me të dhënat e publikuara në regjistrë apo që nuk i gjejnë të publikuara në të, mund të paraqiten pranë sporteleve tona për sqarime dhe informacion më të deta-

juar. Gjithashtu, ATP ka filluar punën dhe së shpejti do të përfundojë procesin e vlerësimit financiar të vendimeve përfundimtare të vitit 1998 dhe në vijim sipas rendit kronologjik do të vlerësohen të gjitha vendimet, të cilat kanë njohur të drejtën e kompensimit të subjekteve të shpronësuar për të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

DOSET E PËRFUNDUARA

Me përfundimin e procesit të vlerësimit financiar të

vendimeve përfundimtare të vitit 1997, si dhe nga përditësimi i regjistrit të vendimeve për vitet 1993-1996, numri total i vendimeve të viteve 1993-1997, që kanë njohur të drejtën e kompensimit të subjekteve të shpronësuar për të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe që janë vlerësuar financiarisht e publikuar nga ATP është 17 318 vendime. ATP, nga hyrja në fuqi e Ligjit nr.133/2015 e deri më tani ka përfunduar vlerësimin financiar për 67%

të të gjithë vendimeve përfundimtare, që kanë njohur të drejtën e kompensimit të subjekteve të shpronësuar për të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Me ecurinë e punës së deritanishme, kjo falë edhe sistemit "Web-Gis" të implementuar nga ATP, ky proces parashikohet të përmbyllet përpara afatit të përcaktuar në ligj për përfundimin e vlerësimit financiar të të gjitha vendimeve përfundimtare, që kanë njohur të drejtën e kompensimit.

EMRAT E 1462 PRONARËVE QË KOMPENSOHEN

Qarku	Emri (Subjekti Kerkues)	Atesia	VLERESIMI
-------	-------------------------	--------	-----------

(Vijon nga numri i djeshëm)

Korçë	Enver Alickolli		
Fier	Trashgimtaret		
Fier	Trashgimtaret		1,091,072
Tiranë	NURIE HAJDAR SULTA		1,544,167
Tiranë	XHEMAL ALI PAZARI		764,524
Tiranë	SKENDER ÇULLHAJ		787,746
Tiranë	MAKBULE SEFA		330,913
Tiranë	ZIJA ÇULLHAJ		1,436,249
Tiranë	ZYDI EGRA		
Tiranë	TIRE BEGA		7,382,331
Tiranë	IBRAHIM SEJDINI		62,682,984
Tiranë	RESHIT SHKOZA		
Korçë	Nestan Kolami		440,400
Elbasan	PARTIZAN KAPTELLI		527,006
Berat	Faik Germeji		1,424,448
Tiranë	REXHEP SHKALLA		
Tiranë	SELIM PICALLI		
Tiranë	QERIM LAMI		356,131
Tiranë			6,077,392
Tiranë	MUHARREM ISUFI		6,149,086
Tiranë	VAJE DOKU		2,452,181
Tiranë	MALIQ DEMNERI		1,901,800
Tiranë	ISLAM QERSHORI		2,297,508
Tiranë	MATJA		339,471
Tiranë	SHYQYRI MILLA		
Lezhë	Mark Preng Zefi		
Tiranë			114,108

Qarku	Emri (Subjekti Kerkues)	Atesia	VLERESIMI
-------	-------------------------	--------	-----------

Tiranë	SADI HYSEN REXHA		546,863
Tiranë	REXHEP MUSA KARAJ		
Tiranë	REXHEP BASTARI		597,469
Tiranë	NEXHAT KARAPICI		1,481,883
Tiranë	HAXHI SINANI		955,940
Tiranë	ADEM BURNACA		0
Tiranë	RAMAZAN HIMA		2,396,268
Tiranë	GJATA		832,756
Tiranë	SHQIPONJA VATHI		707,470
Lezhë	Zef Gjon Miloti		
Tiranë	ALI E LILA TIRANA		8,066,175
Tiranë	SOTIRA PLLUSKA		
Fier	Bajram Shehu		
Fier	Viktor Ikonomi		
Fier	Jakov Milaj		
Gjirokastrë	Koco Miko		222,486
Korçë	Skender Spaho		3,704,400
Korçë	MUHAMET SHAHOLLI		236,791
Korçë	Gazi Lindraku		653,900
Dibër	ISLAM MERTINI		
Tiranë	AQIF MUÇA		1,712,571
Tiranë	SINAN MARA		3,584,000
Tiranë	SHPETIM RAMAZAN K		-9,940,480
Tiranë	LULZIM TAKU		
Durrës	Xhemal Teta		
Korçë	Haki Muka		196,577
Durrës	Ymer Reçi		2,446,605
Lezhë	Gjergj Mark Ndoji		
Korçë	Emine Muka		198,325

Qarku	Emri (Subjekti Kerkues)	Atesia	VLERESIMI
-------	-------------------------	--------	-----------

Korçë	NASTASI PAPANHAMI		272,802
Korçë	Spiro Shopi		1,823,653
Korçë	Eqrem Gegolli		1,654,070
Fier	Reshat Zeqaj		
Fier	Edmond Janushi		7,473,412
Fier	Ahmet Çobra		7,470,222
Fier	Thoma Bakalli		1,289,300
Fier	Kujtim Morina		
Fier	Kamber Metushi		
Korçë	Abasali Jazxhi		1,033,246
Korçë	Fani Vangjel		
Korçë	Sulejman Rusi		470,465
Tiranë	GENC HOTI		18,282,537
Tiranë	FATMIRA POJANI		37,502,640
Tiranë	KADRI ETJ ALLA		
Tiranë	FRANC PALI		64,022,364
Dibër	ISLAM QAZIM TASHA		
Dibër	NEZIR SEIT LLESHI		
Dibër	FEHMI JELLA		
Dibër	HYSEN MUHARREM JELLA		
Dibër	NURÇE QAMIL TOSKA		
Korçë	Sabri Spaho		
Korçë	Sabri Spaho		57,792
Lezhë	Ndue Geg Nikolli		188,186
Lezhë	Gjon Preng Marku		82,196
Gjirokastrë	Urani Haje		
Elbasan	MAHMUT DEHIMA		-31,548,700
Korçë			38,880
Tiranë	HAMDİ MURTHI		7,814,178

Tiranë	HAMDI MURTHI	8,271,765
Korçë		975,896
Korçë	Selajdin Meka	1,684,287
Korçë	Aishe Peroma	156,435
Kukës	Ramadan Geca	951,529
Korçë		469,306
Fier	Trashgimtaret	495,378
Fier	Neim Murataj	7,830,977
Fier	Ali Cakaj	
Fier	Qemal Zotaj	1,514,139
Lezhë	Preng Dede Doci	
Tiranë	MUHARREM STERMASI	
Tiranë	RAMAZAN BALLA	
Tiranë	ÇEKERRI	
Tiranë	MUCA IDRIZ	1,082,301
Tiranë	XHAVIT KRUA	
Tiranë	RAMAZAN BEQIRI	
Tiranë	Kadri Pazari	
Berat	Baki Qama	
Shkodër	Cake Mehaj	
Fier	Ismail Gjata	
Fier	Kujtim Sinani	
Fier	Hasan Balla	5,241,730
Fier	Fitim Feleqi	58,415,272
Fier	Qanie Beqiri	3,955,085
Fier	Safet Henzzi	431,791
Fier	Behije Shehu	1,422,538
Fier	Vasil Dhima	4,482,722
Fier	Ilmi Myftari	326,867
Fier	Hajdar Strumi	6,544,976
Fier	Monki Dhana	7,801,099
Tiranë	QEMAL DAJA	1,048,267
Tiranë	IBRAHIM PUPA	1,876,099
Tiranë	BAJRAM HOXHA	
Fier	Nasi Dhima	7,826,897
Fier	Koli Goxhomani	774,158
Fier	Jorgji Prifti	
Dibër	ISLAM HOXHA	
Dibër	RIZA HAZIS LETI	34,369
Dibër	MERSIN SULEJMAN MJESHTRI	
Dibër	OSMAN SELMAN BALLA	
Dibër	MERIBAN XHEKA	
Kukës	Mehmet Rame Kapica	313,104
Kukës	Ismail Avdi Guri	191,823
Kukës	Zenepe Sadik Perzhita	1,776,021
Kukës	Qemal Mahmut Beqiraj	276,800
Kukës	Xhevdet Selman Murati	
Kukës	Sali Sule Basha	1,347,065
Kukës	Zyber Mustaf Vata	842,169
Kukës	Selman Ali Vata	841,467
Shkodër	Prend Ndue Lufi	822,010
Shkodër	Nikoll Zef Gjoni	
Durrës	Mark Shota	4,186,185
Durrës	Rustem Syziu	
Durrës	Sabri Llubani	
Durrës	Andrea Rexha, Llasbi Rexha	
Durrës	Eqerem Faja	
Durrës	Ilirjana Prusha	
Lezhë	Gjon Preng Deda(Gjoka)	1,228,330
Lezhë	Gjin Ndue Ndoji	744,652
Tiranë	AGIM KOKONOZI	
Korçë	Adil Mullaj	620,117
Dibër	Kisha Ulez	
Lezhë	Zoje Shkëmbi	
Lezhë	Ndue Gjet Gjonaj	
Gjirokastër	Kule Bitri	
Tiranë	IDRIZ ALLMETA	1,200,640
Dibër	Kasem Kasmi	
Dibër	Mark Gjergj Lala	2,290,742
Fier	Mirjana Babamusta	9,118,329
Fier	Llazar Sako	6,048,751
Fier	Izet Ruka	7,593,166
Fier	Hekuran Kumanaku	4,933,123
Fier	Petraç Dimi	1,605,660
Fier	Sadedin Ago	
Fier	Haki Luarasi	
Fier	Haki Luarasi	652,968
Fier	Sefer Alushllari	
Fier	Hasan Llagiu	
Fier	Konica Bukuroshi	1,305,937
Fier	Haki Zavalani	13,560,174
Fier	Elisabeta Poda	
Fier	Bido Nuhaj	3,630,464
Korçë	Njazi Bleta	510,510
Korçë		836,125
Lezhë	Hajredin Qyshka	-2,956,500
Korçë	ILO POPLLO	1,109,626
Korçë	HAXHI BAROLLI	740,121
Korçë	Riza Pasho	
Korçë	Bektash Laho	2,871,557
Korçë	Avni Male	399,981
Kukës	Sadik Shuti	
Gjirokastër	Alem Muharrem Shehu	2,266,274
Korçë	Ibrahim Cane	593,330
Korçë	Refije Backa	70,139
Korçë		97,957
Shkodër	Maruka Gjoni	2,400,462
Shkodër	Angjelina Lekovia	
Shkodër	Riza Haxhija	1,497,049
Korçë		34,400
Korçë		100,073
Kukës	Hanife Shaqir Murati	1,385,575
Fier	Tomor Hoxha	
Fier	Kostandin Sharra	2,149,291
Fier	Syrja Rrapaj	8,628,622
Fier	Islam Majaci	932,812
Fier	Petraç Xoxa	
Fier	Hajdar Breshnica	4,078,256
Fier	Banush Kumanaku	3,329,068
Fier	Hetem Goga	
Fier	Perikli Ongari	6,233,631
Fier	Sokrat Samarxhiu	1,659,182
Fier	Nexhmie Henzi	1,041,150
Fier	Kostandin Dhima	
Fier	Novruz Mullaj	4,268,380
Fier	Vasillaq Prifti	40,142
Fier	Alqi Kusta	
Korçë	Petrika Çili	232,247
Korçë	Shega Xhafka	179,777
Korçë		1,568,959
Korçë	Harvid Dervishi	1,245,017
Korçë	Muhamet Zhilla	
Korçë	Ali Petriti	
Korçë	Behar Bregu	-379,000
Korçë	Mitat Çika	-9,827,700
Korçë	Stavri Prenda	
Lezhë	Llesh Gjet Nikolli	
Korçë	Nurihan Mece	183,697
Korçë	Ollgë Bode	588,360
Korçë	Naum Palla	693,301
Korçë	Burbuqe Konomi	291,976
Korçë	Viktor Cami	98,060
Korçë	Dituri Lenja	662,167
Korçë	Guralije Hoxha	1,683,229
Korçë	Pranvera Baruti	2,434,639
Korçë	Lumturi Lipo	1,029,731
Korçë	Njazi Petriti	429,514
Korçë	Thanas Moni	883,113
Korçë	Shkende Xhaçi	2,100,180
Shkodër	Andrea Martini	51,611
Shkodër	Sanije Druni	653,733
Shkodër	Muhamet Lohi	1,083,821
Gjirokastër	Hysen Seiti	59,257
Gjirokastër	Rrapo Lumani	302,208
Gjirokastër	Brahim Jashari, Sali Jasha	248,877
Fier	Shyqyri Rustemi	7,048,465
Dibër	ASTRIT RIFAT MUHA	
Dibër	RAMAZAN HASAN META	
Dibër	MIFTAR XHEM MARTINI	
Tiranë	MEHMET BYLYKBASH	7,366,590
Fier	Seit Seitaj	5,162,724
Fier	Thoma Duda	6,544,976
Fier	Beshir Bushi	6,254,734
Fier	Urani Toska	7,664,920
Fier	Qamil Sukaj	704,483
Fier	Selam Fejzaj	3,241,904
Korçë	Mjallaq Gjylameti	2,040,673
Korçë	Kusto Tytymçe	
Korçë	NIGJARE QAMKA	690,750
Korçë	Gjok Percini	243,793
Korçë		46,528
Korçë	Dhimitri Ilo	0
Korçë		0

Opinion i Ditës

Ritmi i Rrugës së Kombit

Nga Julian Zyla

(Vizion nga faqja e parë)

... Reçi. Ish-anëtari i 'Ritmit të Rrugës' ndodhej në një kafe të Prishtinës kur argumentoi, me pirun në dorë, se tashmë, që të shkonte në Shqipëri, do të duhej që "një i Shqipnisë" t'i paguante autostradën.

"Jam gati të shkoj në Tiranë dhe t'i paguaj drekën," përsëriste Arbri, "por autostradën duhet të ma paguajë ai."

Arbri dukej të mos ishte i vet-

është gdhendur në gur. Aq më tepër kur njerëzit vendosin t'i lëvizin gurët.

Kryeministri tha se janë bërë studime teknike dhe janë përcaktuar kostot. Po studime sociale u bënë? Kryeministri Rama pranoi që mund të ketë dështuar në komunikimin paraprak të detajeve me të interesuarit. Kjo ishte hera e tretë. Dy protestat e mëparshme kishin specifikë thauja se njëjtë:

detaje të rëndësishme nuk ishin komunikuar paraprakisht. Pastaj, e dimë: ndodhën protestat dhe ndodhi ndryshimi i planeve në bazë të zërit të dëgjuar me vonesë

lider vërtet modern, i cili kërkon në mënyrë aktive mendimin e njerëzve në momentin e duhur, apo do të vazhdojë me një udhëheqje hibride e tipit "unë ju dëgjoj kur protestoni". Qasja e deritanishme duket e paorganizuar dhe joperëndimore.

A duhej vendosur pagesa në Rrugën e Kombit? Po, por nëse do të pyeteshin njerëzit do të kuptoheshin që ajo tarifë mund të ishte një ritëm i shurdhët. Argumentet aritmetike se "nuk kalojnë shumë makina" dhe se vetëm "ata që do të kalojnë rrallë do të paguajnë aq shumë" janë të pandjeshme ndaj

taksuar dhe se sistemi po krijohet për qëllime fitimi.

Sikur të gjithë argumentet tekniko-financiare të jenë në favor të tarifimit 5 euro (10 euro vajtje-ardhje), nuk mund të anashkalohej edhe aspekti kombëtar. A është ky një argument që të mos vendoset pagesë? Sërish, jo. Por duhej nisur me një pagesë më të pranueshme. Një pagesë që t'i bënte shqiptarët e Kosovës të mos ndiheshin të sulmuar, por të mirëpritur. Një pagesë e ulët mund të ndikojë psikologjikisht që njerëzit të mendojnë se është ide e mirë të përshkohet më shpesh Rrugja e



mi në Kosovë që kishte kundërshiti, jo për vendosjen e një tarife, por për nivelin e tarifës në Rrugën e Kombit. Nuk ishte vetëm çështje mundësisht, por e shihnin si një fytyrë kombëtare.

Ndërkohë, protestat nga banorët e Kukësit të sjellin vëmendjen te fakti se ajo rrugë ka disa palë të përfshira emocionalisht, financiarisht. Atëherë, çfarë do të ndodhë? Duke parë ngjashmërinë mes protestës për rrugën e Kombit dhe dy të tjerave që çuan në refuzimin e mbetjeve të armëve kimike dhe atyre për riciklim, nuk mund të përjashtohet që kryeministri i Shqipërisë ta dëgjojë sërish zërin e njerëzve dhe tarifa e panegociueshme prej 5 eurosh të negociohet. Ritmi i Rrugës së Kombit, nuk

të njerëzve. Pse ndodh kjo? Pse Kryeministri/qeveria nuk arrijnë t'i sqarojnë njerëzit më herët?

Gabimi që bëhet nga qeveria është mendimi se meqenëse opozita është e dobët, njerëzit janë të pafuqishëm. Pas protestave krejt të ndryshme nga ato që falin luksin politik t'i përhapësh, prej qeverisë duhet të kuptohet tashmë qartë dallimi mes organizimeve politike të opozitës dhe atyre të njerëzve të indinjuar për çështje konkrete.

Kryeministri nuk duhet të vazhdojë vetëm të reagojë në lidhje me njerëzit. (Nuk ka nevojë të thuhet "njerëzit e zakonshëm".) Të gjithë jemi të (jashtë)zakonshëm.) Atij i duhet të vendosë nëse do që të jetë një

rrethanave sociale dhe (gjeo)politike.

Rrugët me pagesë njiheshin që në shekullin e 12 në Angli dhe si-pas enciklopedisë së Columbias u autorizuan me ligj që në shekullin e 14. Amerikanët nisën ta përdornin këtë lloj financimi të ndërtimit dhe mirëmbajtjes të disa rrugëve pas revolucionit. Një autostradë në Pensilvani, e para rrugë e rëndësishme me pagesë në SHBA, u ndërtua në vitin 1792. Rastet në të gjithë botën janë tashmë pa fund. Por, jo të gjitha rrugët që kanë kosto të lartë ndërtimi dhe/apo mirëmbajtjeje janë me pagesë. Ky sistem krijohet për të shmangur taksimin e atyre që nuk do ta përdornin rrugën. Por tashmë të gjithë janë të bindur se janë

Kombit, sepse kushton pak. Kjo edhe krahasuar me kohën kur merrej e mirëqenë, sepse ishte falas. Në çdo rast, duhen lejuar uljet për përdoruesit e shpeshtë.

Pra, duke përmbledhur, ky debat ka dy anë. Njëra anë është aspekti i vendimit konkret lidhur me çështjen, për të cilën qeveria duhet të marrë parasysh jo vetëm kuadrin financiar, por edhe atë social e kombëtar. Dhe tjetra është përsëritja e moskonsultimit publik paraprakisht. Dëgjuesat reale janë një mundësi për realizim të një udhëheqjeje vërtet moderne e frymëzuese.

Arbër Reçi pranoi se do ta paguante vetë tarifën nëse do të ishte më pak. Pak më vonë, ishte e pamundur ta bindje të mos paguante tavolinën.

HOROSKOPI

DASHI

Shqetësimi nuk do të jetë i lehtë për t'u mbajtur nën kontroll. Do të bëjë që marrëdhëniet me të tjerët t'i kenë sipas kapricëve të humorit. Qetësohuni! Nuk do të pranoni propozimin e një të njohurit sepse më vonë do t'i ndiheni në borxh.

DEMI

Ironia e juaj therëse, sot bëhet më e hidhur nga ndikimi negativ i Merkurit. Në vend që t'i përgjigjeni ftesave të njeriut të zemrës, do të parapëlqeni të rini me miqtë. Më pas do të përpigjeni të fitoni kohën e humbur, por nuk do të jetë e thjeshtë.

BINJAKET

Në familje do të keni disa kundërshtime të shkakta nga këndvështrimet e ndryshme. Mos u mërzisni: larmishmëria është gjithmonë diçka pozitive, që duhet shfrytëzuar për t'u ngritur. Falënderoni kolegët që ju rrinin para duke ju dhënë ide dhe mundësi të mira.

GAFORJA

Sot yjet nuk janë shumë të shkëlqyeshme. Do të shqetësoheni për çështje profesionale, të cilat do të dalin se nuk janë problematike! Në punë mos bini shumë në sy, rriti të qetë dhe shfaqini aftësitë e juaja në momentin e duhur.

LUANI

Me mbështetjen e Merkurit për me armiqërinë e Marsit dhe Venusit, Hëna në qiellin e juaj do të bëjë që të ndiheni faktor në frontin e dashurisë. Është e kotë të prisni ndryshime në punë. Jeni ju që duhet të bëni diçka për t'u ngritur në detyrë.

VIRGJERESHA

Jeni të hapur për bashkëpunime dhe të gatshëm të jepni ide të reja. Sa keq që Merkuri angazhohet duke ju vënë shkopin në rrota. Do të dini të vlerësoni plotësisht personin që ju rri për krahu dhe t'i kushtoni vëmendjen e duhur.

PESHORJA

Do të kaloni pengesat dhe do t'ia dini më në fund të vëni në zbatim një ide që e keni lënë mënjanë prej kohësh për shkak të pasigurive. Një takim i papritur do t'ju shtrëngojë që të përballeni me probleme të hershme dhe t'i zgjidhni ato.

AKREPI

Kujdes nga çështjet që kanë të bëjnë me financat, sepse mund të shkaktohen vonesa dhe pengesa në pagesa. Më mirë të marrini vetë më këto gjëra. Shqetësimi në fushën e dashurisë, për shkak të Venusit kundra, mund të bëjë që të merrni vendime gjaknxehta.

SHIGJETARI

Qëndroni afër një bashkëpunëtori që ka zakot të flasë pak si shumë. Ka rrezik që të përhapë fjalë jo shumë të mira për ju. Mund t'i kërkonti këshillë kujt të doni, pos mos lejoni të ndikoheni për zgjedhje që kanë të bëjnë me fushën e dashurisë.

BRICJAPI

Jupiteri do të bashkëpunojë me Diellin e Hënës, duke ju favorizuar së tepërmi. Sot do të jeni optimist, dhe do t'ia dini të merrni çdo gjë që doni me angazhim minimal. Potenciali krijues është në nivelet më të larta për këtë muaj.

UJORI

Hëna do të ndikojë në ritmet e ditës do të bëhen të paqëndrueshme. Do të jetoni momente kënaqësie, por edhe çaste pasigurie. Mos e shmangni afrimin e një personi që keni njohur së fundmi, mund t'ju bëjë kureshtarë më shumë sesa mendoni.

PESHQIT

Nëse jeni beqar, dikush do t'ju afrohet me ndjenja të sinqerta, po ngadhënjimi nuk do të jetë i lehtë. Do të pretendoni gjithmonë shumë. Në horizont shquhen mundësi të mira profesionale, që duhen shfrytëzuar menjëherë. Mos i lëni t'ju ikin.

Katovica

Thellim i çarjes strategjike në Ballkanin Perëndimor

(Vijon nga faqja e parë)

Nga SHABAN MURATI

Shqipëria, Kosova dhe forcat politike në trevat e tjera shqiptare, nuk mund të mos shohin se ka një tensionim antishqiptar të situatës në Ballkanin Perëndimor.



... dëbuar diplomatë rusë, kurse dy shtete Serbia dhe Bosnjë-Hercegovina nuk iu bashkuan këtij qëndrimi. U kristalizua edhe njëherë vija e ndarjes në rajon midis kampit properëndimor dhe kampit proruse. Ndodhi e njëjta gjë si me sanksionet ekonomike të BE kundër Rusisë në vitin 2014, të cilat Brukseli i vendosi si dënim për aneksimin e dhunshëm të Krimesë nga Rusia dhe për ndezjen e luftës separatiste proruse në Ukrainën Lindore. Tre shtete të Ballkanit Perëndimor: Shqipëria, Mali i Zi dhe Kroacia iu bashkuan në atë kohë sanksioneve të BE, kurse Serbia, Bosnjë-Hercegovina dhe Maqedonia e drejtuar nga kryeministri proruse Nikolla Gruveski kundërshtuan sanksionet dhe përkrahën Rusinë. Tani qeveria e re e kryeministrit Zaev iu bashkua linjës së përbashkët properëndimore, duke dëbuar një diplomat rus, me gjithë kundërshtimin e presidentit proruse të Maqedonisë, Gjorgje Ivanov, i cili doli me komunikatë se ishte kundër.

Ndarja rajonale në dy kampe në zhvillimet e tanishme, njësoj si në kohën e krizës ukrainase, dëshmon thellimin e vijës së çarjes strategjike të Ballkanit Perëndimor. Pavarësisht se kjo çarje është në fushën e politikës së jashtme, ajo provon se sa i vështirë është integrimi real evropian i rajonit të quajtur "Ballkan Perëndimor". Fakti që një shtet si Serbia, shtet kandidat që ka filluar bisedimet e pranimit në BE, dhe një shtet si Bosnjë-Hercegovina, që aspiron të hyjë në BE, po i kundërvihen politikës së jashtme të BE, krijon një situatë absurde ballkanike dhe e vë shumën në dyshim orientimin e tyre zyrtar për anëtarësim në BE. Këto ndarje provojnë se Ballkani Perëndimor po thellon pozicionet strategjike në dy pole të ndryshme, njeri grup drejt integritetit euroatlantik dhe grupi tjetër drejt integritetit rus.

Kjo çarje strategjike në Ballkanin Perëndimor po merr drejtime negative për situatat e sigurisë në formën e kërcënimeve të drejtpërdrejta për përdorimin e forcës në rajon midis shteteve. Serbia dhe Rusia ditët e fundit kanë demonstruar një kërcënim flagrant për përdorimin e forcës kundër shteteve të rajonit. Në datën 28 mars, presidenti i Serbisë Aleksandër Vuçiç deklaroi publikisht se ai kishte marrë në konsideratë ndërhyrjen ushtarake dhe dërgimin e ushtrisë serbe në Kosovë në rastin e dëbimit nga Kosova në 5 mars të zyrtarit provokator Marko Gjuric, i cili kishte hyrë pa leje në një shtet tjetër. Presidenti serb kërcënoi se çdo herë që ndeshemi me një situatë të tillë, ju duhet ta konsideroni, gjithashtu, dërgimin e ushtrisë. Natyrisht presidenti serb e di se dërgimi i ushtrisë serbe do të thotë luftë. Në datën 29 mars ambasadori i Rusisë në Maqedoni, Oleg Shcherbak, si kundërpërgjigje ndaj vendimit të qeverisë së Maqedonisë për të dëbuar një diplomat rus, kërcënoi hapur Maqedoninë që të mos hyjë në NATO, sepse mund të përballlet me goditje ushtarake ruse. "Nëse shkohet në një konflikt midis Rusisë dhe NATO-s, ju do të keni rolin e një objekti legjitim", kërcënoi ambasadori rus.

Gjëja e parë, që bie në sy, është që Serbia dhe Rusia në të njëjtën frekuencë tona dhe kohe adresojnë kërcënime për përdorimin e forcës në rajon kundër shteteve, që ndjekin kursin properëndimor.

Kjo fushatë kërcënimi ushtarak evidenton një aktivizim më të madh të Serbisë në funksion të strategjisë së politikës së jashtme të Rusisë për influencë nëpërmjet krijimit të tenseve, trazirave dhe konflikteve në shtete e rajonit. Po manifestohet një koordinim i ngushtë midis Moskës dhe Beogradit në këtë drejtim, siç dëshmon edhe biseda telefonike e presidentit rus Vladimir Putin me presidentin serb Vuçiç në 28 mars, ku, siç deklaroi vetë Vuçiç, i ka kërkuar Putinit këshilla se "si të përballojë dhunën dhe agresionin e Kosovës ndaj serbëve". Dhe presidenti rus, në vend që t'i kujtojë presidentit serb se Rusia i arretion, i dënon dhe i dëbon të gjithë ata shtetas të huaj, që kalojnë kufirin rus pa vizë dhe pa leje, si provokatori Gjuriç

kufirin e Kosovës në 25 mars, e inkurajon agresivitetin e Serbisë. Presidenti serb, pasi deklaroi se kishte konsideruar ndërhyrjen ushtarake në Kosovë, kërcënoi se "Ne do të kemi mbështetje të çdo lloji nga Rusia". Kjo ringjallje e gjuhës së luftës të kohës së Millosheviçit, anëtar i kabinetit të të cilit ka qenë Vuçiç, duhet të tërheqë vëmendjen e veçantë të Brukselit, të Prishtinës, të Tiranës dhe kryeqyteteve të tjera të rajonit.

Duhet pritur që Serbia ta shkallëzojë situatën në Kosovë dhe rreth Kosovës. Jo rastësisht Beogradi, sipas gazetës serbe "Dan" të 30 marsit, që citon burime qeveritare, planifikon të përsërisë provokacionin, duke dërguar në mënyrë të paligjshme Gjuriçin prapë në Kosovë në 20 prill. Kjo do të thotë

që Beogradi po kërkon me qëllim të hapë sherr të madh dhe konflikt me shtetin e pavarur dhe sovran të Kosovës. Qeveria e Aleksandër Vuçiçit i ka hipur karros së luftës. Ndërkaq në parlamentin serb deputetët po kërkojnë që Serbia të anëtarësohet sa më shpejt në organizatën ushtarake ruse CSTO, të krijuar dhe të drejtuar nga Moska. Në këtë organizatë ushtarake ruse Serbia ka statusin e shtetit vëzhgues në parlamentin e CSTO.

Gjëja e dytë, që bie në sy, është se kërcënimet e Serbisë dhe të Rusisë po drejtohen kundër pjesëve të kombit shqiptar. Serbia po kërcënon direkt popullin shqiptar të Kosovës dhe shtetin shqiptar të Kosovës me ndërhyrje ushtarake. Rusia po kërcënon direkt me përdorimin e forcës ushtarake Maqedoninë, ku afër gjysma e popullsisë së shtetit janë shqiptarë, që do të thotë se efekti i kërcënimit prek pjesën e kombit shqiptar.

Në një situatë të tillë nuk është e këshillueshme që kjo fushatë kërcënimesh serbo-ruse të përdorimit të forcës të kalojë pa u analizuar nga qeveritë dhe partitë politike të dy shteteve shqiptare. Më e pakta do të ishte një proteste drejtuar Serbisë dhe Rusisë. Shqipëria, Kosova dhe forcat politike në trevat e tjera shqiptare, nuk mund të mos shohin se ka një tensionim antishqiptar të situatës në Ballkanin Perëndimor. Përdërisa ka një tensionim të situatës në shkallë evropiane midis bllokut euroatlantik dhe bllokut rus, është e qartë se kjo pritet të shkallëzohet më fort në hallkat e dobëta, në Ballkan, ku Rusia po përdor qeveritë dhe forcat proruse, siç është Serbia dhe e ashtuquajtura "serpska republika".

Shqipëria, Kosova dhe forcat e tjera politike në rajon nuk mund të mos shohin se burimet dhe vatra e kërcënimit real për shtetet shqiptare dhe për kombin shqiptar po vijnë nga po ato qendra antishqiptare, që historikisht kanë dashur dhe duan ta varrosin çështjen shqiptare dhe kombin shqiptar. Sidomos Kosova duhet të ndërjegjësohet për shkallën e lartë të rrezikut, që po i vjen nga Veriu. Prishtina nuk mundet të sillet sikur nuk po ndodh gjë e re dhe sikur në Beograd po bëjnë vetëm teatër. Në Beograd po bëhet teatër me orientimin evropian dhe me integrimin evropian, por nuk po bëhet teatër me strategjinë e vjetër serbe të zhbërjes së shtetit të pavarur të Kosovës. Në Beograd nuk po bëjnë teatër me kërcënimet ndaj sovranitetit, integritetit dhe ekzistencës së shtetit të pavarur të Kosovës. Në Beograd nuk po bëjnë teatër, por me ndihmën e lobit serb po vënë në skenën e Prishtinës teatrin fatkeq të largimit të vëmendjes shtetërore dhe publike nga rreziku serb. Serbia dhe lobi serb në Prishtinë po përpiqen ta hapërdajë vëmendjen shtetërore dhe publike shqiptare në drejtim të paditura dhe në horizonte gjeografike të kontinenteve të tjera. Një popull dhe një komb që e sheh dhe e kërkon armikun dhe rrezikun në hava, kur armikun dhe rrezikun i ka tek dera, bëhet vullnetarisht një pre e lehtë.

Shqipëria, Kosova, populli shqiptar në Maqedoni dhe gjithë shqiptarët, duhet të kujtojnë se kërcënimet dhe kafshimet sot po u vijnë po nga ata shtete, që na kanë grabitur territoret në shekuj. Ninullat idiotë të "integritimit rajonal" apo të "familjes dhe vëllazërimit ballkaniko-perëndimor" janë për naivët dhe për të fikur alarmet kombëtare.

Ninullat idiotë të "integritimit rajonal" apo të "familjes dhe vëllazërimit ballkaniko-perëndimor" janë për naivët dhe për të fikur alarmet kombëtare.

Përfundojnë negociatat në Vjenë, ende s'ka një vendim për marrëveshjen

Mediat greke: Athina tërhiqet nga emri i Maqedonisë

Dimitrov: Spekulumet jozyrtare janë të dëmshme

Edhe pas raundit të negociatave në Vjenë, as ndërmjetësi i OKB-së, Nimic e as dy kryediplomatët, Dimitrov e Kocias nuk treguan se cilat ishin rezultatet konkrete të takimit, mediat greke publikojnë detaje. Sipas TV Sky dhe Antena, Athina është tërhequr nga kërkesa për emër të pandashëm dhe të papërkthueshëm, por se në kthim kërkon që emri të jetë erga omnes që do të nënkuptonte ndryshim të Kushtetutës dhe veçanërisht të Nenit 49 të saj. Kështu shkruan edhe e përditshmja Kathimerini. "Sipas burimeve diplomatike, pengesat kryesore janë nenet irredentiste të Kushtetutës së IRJM-së dhe emri që do ta përdorë në vend dhe jashtë vendit. Burimet e njëjta thonë se Athina do ta konsideronte marrëveshje nëse Shkupi ndryshon nenin 49 të Kushtetutës, i cili u referohet qytetarëve nga IRJM-ja në diasporë, në mënyrë që të mos ketë irredentizëm" - shkruan Ekathimerini. Ndonëse ky informacion mbetet zyrtarisht i pakonfirmuar dhe i papërgjeshtruar, është e paqartë se çfarë në të vërtetë do të mund të kërkonte pala greke. Neni 49 që parashikon se "Republika kujdeset për të drejtat e qytetarëve të Republikës jashtë vendit", në vitin 1992 është plotësuar me Amendamentin II, sipas të cilit "Republika, me këtë rast, nuk do të përzihet në të drejtat sovraane të shteteve tjera dhe në punët e tyre të brendshme". Pas takimit të mbrëmshëm, mediat greke, gjithashtu, raportuan se Shkupi është i gatshëm për ndryshime kushtetuese. Por kjo nxitë reagoime të

MEDIA GREKE

"Sipas burimeve diplomatike, pengesat kryesore janë nenet irredentiste të Kushtetutës së IRJM-së dhe emri që do ta përdorë në vend dhe jashtë vendit. Burimet e njëjta thonë se Athina do ta konsideronte marrëveshje nëse Shkupi ndryshon nenin 49 të Kushtetutës, i cili u referohet qytetarëve nga IRJM-ja në diasporë, në mënyrë që të mos ketë irredentizëm" - shkruan Ekathimerini.



Nikolla Dimitrov

NENI 49

"Republika kujdeset për të drejtat e qytetarëve të Republikës jashtë vendit", në vitin 1992 është plotësuar me Amendamentin II, sipas të cilit "Republika, me këtë rast, nuk do të përzihet në të drejtat sovraane të shteteve tjera dhe në punët e tyre të brendshme".

e Shkupit është e gatshme të bëjë ndryshime të caktuara në Kushtetutën e vendit. Përmendja konkrete është provokim i qëllimshëm nga ana e secilës media që e ka përcjellë informata konkrete" - thuhet nga Ministria e Jashtme e Greqisë. Nga treshja e diplomatëve, Nimic-Dimitrov-Kocias takimi i para dy ditëve u vlerësua si pozitiv dhe progresiv, por se, megjithatë, mbeten akoma vështirësi për t'u tejkaluar. U paralajmërua një takim tjetër pas Pashkëve, në të cilin sipas Kocias-it pritet të hidhet "hapi i madh". Ndërsa nuk përjashtohet mundësia që pos ministrave të Jashtëm, të takohen edhe kryeministrat e dy vendeve, raporton Alsat M.

MINISTRI I JASHTËM, NIKOLLA DIMITROV

"Procesi i çështjes së emrit është në fazë delikate dhe spekulumet e disa mediave janë të dëmshme. Qëndroj pas deklaratës time publike dhe informoj opinionin se nuk kam bërë ndonjë brifing joformal shtesë. Asnjë burim diplomatik e as ndonjë burim tjetër nuk ka thënë se pala e Shkupit është e gatshme të bëjë ndryshime të caktuara në Kushtetutën e vendit. Përmendja konkrete është provokim i qëllimshëm nga ana e secilës media që e ka përcjellë informatën konkrete", -tha ministri i Jashtëm Nikolla Dimitrov.

menjëhershme të ministrit, Dimitrov dhe Ministrisë së Jashtme greke. "Procesi i çështjes së emrit është në fazë delikate dhe spekulumet e disa mediave janë të dëmshme. Qëndroj pas deklaratës time publike dhe informoj opinionin se nuk kam bërë ndonjë brifing jo-

formal shtesë" - deklaroi Ministër i Jashtëm Nikolla Dimitrov. "Asnjë burim diplomatik e as ndonjë burim tjetër nuk ka thënë se pala

formal shtesë" - deklaroi Ministër i Jashtëm Nikolla Dimitrov. "Asnjë burim diplomatik e as ndonjë burim tjetër nuk ka thënë se pala

Deportimi i turqve, presidenti reagon ndaj akuzave të kreut të Vetëvendosjes

Hashim Thaçi: Kurti financohet nga Irani dhe takohet me njerëz të presidentit Putin

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, në një konferencë për media, lidhur me deportimin e shtetasve turq, ka komentuar edhe akuzat e liderit të Vetëvendosjes, Albin Kurti dhe opinionistëve se presidenti ka qenë në dijeni për arrestimin dhe deportimin e gjashtë turqve. Thaçi thotë se sa i përket asaj që ka lexuar nga një opinionist nga Shqipëria, "akuzat e tyre janë zero dhe janë njerëz dhe zëra të atyre që kanë djegur Shqipërinë në vitin 1997, por këtë në Kosovë nuk do t'ia arrijnë". Sa i përket liderit të Vetëvendosjes, Thaçi tha se Kurti iu është bërë obsesion emri i tij, prandaj porositi gazetaret që ta pyesin Kurtin për ekipet e Vetëvendosjes që i çon ai në trajnimin në Stamboll. "Është mirë t'ju tregoj juve



Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi

se kush i çon ekipet e tij të rregullta mujore në trajnime në Stamboll. Kush janë atë njerëz që i trajnojnë dhe financojnë këta njerëz të VV-

së. Kurti duhet të tregoj edhe kush janë njerëzit nga Irani, që ia financojnë partinë dhe atë personalisht. Për këtë mund t'ju tregoj edhe

HASHIM THAÇI

"Kurti duhet të tregojë edhe për lidhjet e tij me njerëzit e Putinit që janë instaluar në Ballkanin Perëndimor dhe me të cilët takohet nganjëherë në vende të ndryshme të Ballkanit dhe jashtë. Ai njeri është dhe ideatori dhe njerëzit e rrethit të tij themeluesit e organizatës terroriste 'Syri i Popullit', që ka përpiluar lista për ekzekutimin e njerëzve në Kosovë, Maqedoni e Shqipëri", - tha Thaçi.

Glauk Konjufca. Përgjigjen e dinë ata, e di edhe unë. Lë ta dijë edhe populli i Kosovës", tha Thaçi, raporton Telegrafi. Më tej Thaçi tha se "Kurti duhet të tregojë edhe për lidhjet e tij me njerëzit e Putinit që janë instaluar në Ballkanin Perëndimor dhe me të cilët takohet nganjëherë në vende të ndryshme të Ballkanit dhe jashtë".

"Ai njeri është dhe ideatori dhe njerëzit e rrethit të tij themeluesit e organizatës terroriste 'Syri i Popullit', që ka përpiluar lista për ekzekutimin e njerëzve në Kosovë, Maqedoni e Shqipëri", tha Thaçi, duke akuzuar Kurtin se agenda e tij përpunohet me atë të Serbisë që nga Rambujeja.

SHKURT

Sfidë për Macronin/ Valë grevash, plehra në rrugë për francezët

Bëhet fjalë për ruajtjen e disa privilegjeve, por edhe për çështjen se sa me themel po e ndryshon vendin presidenti, Emmanuel Macron. Franca ndodhet para matjes së forcave mes qeverisë dhe sindikatave. Kush do të fitojë? Javët e ardhshme jeta e francezëve nuk do të jetë shumë e këndshme. Plehra në trotuare, sepse qendra e organizimit të mbledhjes së plehrave ndodhet në grevë, mungesë rryme elektrike në disa reparte prodhimi, sepse sindikata e energjisë del në grevë, mungesë trenash, sepse tek hekurudha franceze, SNCF rreh zemra e rezistencës kundër reformës së planifikuar nga presidenti Macron. Madje edhe nëse do t'i ikësh kësaj situatë, ka gjasë të mos e bësh dot, sepse punonjësit e shoqërisë së fluturimit, Air France do të dalin në grevë. Katër muaj me radhë sindikatat franceze lëpinin plagët për të kaluar goditjen më të dendur, dëshimin në grevat e vjeshtës 2017. Vërtet që disa lëshime ato i morën qeverisë për reformimin e së drejtës së punës, por nuk mundën ta pengonin dot futjen e fleksibilitetit në tregun e punës. Qeveria ia doli të ndante sindikatat. Mobilizimi në rrugë ishte i dobët. Këtë pranverë gjërat duhet të ndodhë ndryshe, shpresojnë sindikalistët.


Helmimi i Skripal/ Diplomati rusë lënë Washingtonin

Diplomatët e dëbuar rusë kanë lënë ambasaden e tyre në Uashington për të fluturuar drejt Rusisë, shkruan BBC. Ata u nisën drejt Kremllit me dy avionë nga Aeroporti Ndërkombëtar i Uashingtonit. Zyrtarët Rusë u larguan nga Shtetet e Bashkuara si pjesë e një reagoni ndërkombëtar, pas helmimit të ish-spiunit Sergei Skripal dhe bijës së tij në Britaninë e Madhe më 4 mars 2018. Një sërë shtetesh dëbuan diplomatët rusë, ku mes tyre është dhe Shqipëria.

Thirrja e Papës për Pashkë: Mos heshtni para padrejtësisë!

Pashkët katolike janë kremtuar ditën e djeshme me një meshat e zakonshme të drejtuar nga Papa Françesku në Vatikan. Në mes të mesnatës së të shtunës, në Vatikan me rastin e pashkës katolike, Papa Françesku bëri thirrje për më tepër angazhim kundër padrejtësisë. Sipas atit të shenjtë, padrejtësia është kthyer në rutinë dërrmuese që po justifikohet me sloganin "Gjithnjë kështu ka ndodhur". Papa Françesku po drejton edhe meshat tradicionale të pashkës ku jepet edhe mesazhi "Urbi et Orbi". Dhjetëra mijëra besimtarë nga mbarë bota janë mbledhur në sheshin Shen Pjetër; i blinduar nga masa të rrepta sigurie nga rezikulo i sulmeve terroriste.

Fjalëkryqi (1)



- 38. Satelit i Jupiterit.
- 39. Fillojnë matjet.
- 41. Në krye tëv idealisatëve.
- 42. Një Ibrahim violinist.
- 44. Ekstre me sirtar.
- 45. Kështu shtë lojtari i under 21.
- 47. Eshhtë gjuajija personale.
- 49. Mund të ushtrohet edhe psikologjik
- 50. Gëlonin nga gladiatorët.

VERTIKAL

- 1. Eli këngëtare.
- 2. Pak ekologjike.
- 3. Rastis në kufij.
- 4. Janë temperaturat më të ulëta.
- 5. Inicialet e Lendl.
- 6. Jetojnë në kryeqendrën piemonteze.
- 7. Campion regjisore.
- 8. Gabim rrjete në tenis.
- 11. Janë si cilësi.
- 12. Ishtë gjuha e romakëve.
- 15. Flet për bëmat e kreshnikëve.

HORIZONTAL

- 1. Ishtë dekret i sulltanit.
- 8. Fillojnë nazet.
- 9. Eshhtë bosht.
- 10. Eshhtë studio e Barack Obama-s.
- 13. Fillojnë romanin.
- 14. Pak nepozitëm.
- 17. Mbahen për të ndaluar.
- 18. Janë njerëz me dy faqe.
- 21. U mbiquajt Princi i oratorëve.
- 22. Nofka e Eisenhoëer.
- 24. Janë ministri.
- 25. Pak normalitet.
- 26. Rodrigues, që u quajt mbretëresha e fado-s.
- 27. Kush është... nuk është i lirë.
- 29. Bën be pa u betuar një e tillë.
- 30. Kështu mbyllet dera.
- 33. Eshhtë për medaljen e parë
- 34. Janë nofka.

- 16. Janë shërbimet me... korrespondencë.
- 17. I vihët kalit.
- 18. Rrapo i luftëtarëve.
- 19. Aktet pa kufij.
- 20. Mbyllet me dorezë.
- 21. Eshhtë periudha e ftohtë.
- 23. Në krye të komandës.
- 24. Një artist si Tristan Tzara.
- 28. Janë sportistët që bëjnë stil të lirë.
- 31. Hapin pa kufij.
- 32. Qethen me qen.
- 35. Një mendim.
- 36. Kusturica, regjisori.
- 37. Parajsja e humbur.
- 39. Një stacion i famshëm orbital.
- 40. Pak aromatike.
- 43. Pak interesante.
- 46. Lirë në qendër.
- 48. Nota e diapazonit.

Fjalëkryqi (2)

HORIZONTAL


- 1. Bunuel regjisori.
- 4. Të parat në sport.
- 6. Rodriges që këndonte fado.
- 11. I famshmi Pacino.
- 12. Kujdeset në... ekstreme.
- 14. Eshhtë sklavëri.
- 16. Eshhtë shtypi jo përditshëm.
- 18. Janë tek në banka.
- 20. Eshhtë ndeshje e... fundit.
- 21. Lumi i Bernës.
- 23. Janë me numër ato ushtarake.
- 24. Nesti pa pa çiftet.
- 25. Si gjithë.
- 26. Sipërfaqe e shkurtër.
- 27. Ato të peshkut janë pa vlerë
- 28. Janë marifete... me grim.
- 31. Ethet e tij zunë kërkuesit.
- 32. Skuadra merengue.

VERTIKAL


- 33. Eshhtë trofet që fitohet.
- 34. Ndahen nga ortakët.
- 36. Një biçikletë dyshe.
- 39. Qetësonte detin.
- 42. Kanë dhoma që zihen.
- 44. Eshhtë ekulibri në palestër.
- 46. Në krye të jurisë.
- 47. Numri i kuartetit.
- 48. Gjysmë armate.

VERTIKAL


- 1. Gjysma e lapsit.
- 2. Përfundojnë pingul
- 3. Shkruhen për filma.
- 5. Duhen realizuar.
- 6. Gabim pa kufij.
- 7. Portokalli i Stanley Kubrick.
- 8. Në krye të artistëve.
- 9. Eshhtë edhe ai i rekordeve.
- 10. Fleming që krijoi James Bond.
- 13. Janë binarë.
- 15. Janë dhoma.
- 16. Eshhtë i zi... pikant.
- 17. Institucione Lokale Tiranë.
- 19. Pagëzoi Shën Palin.
- 20. Eshhtë besimi i besimtarëve.
- 22. Janë pamje nga puna.
- 26. Janë aksione për... gol.
- 27. Një fjalë për më vonë.
- 29. Maria Rilke, shkrimtar.
- 30. Fillojnë turnin.
- 32. Kupa e fituar gjithmonë nga Brazili.
- 34. Eshhtë copë... torte.
- 35. Mbyllin një tender.
- 34. Ndo në kufij.
- 38. Një pëlhurë.
- 40. Lidh dy brigjet.
- 41. Një pije piratësh.
- 43. Fillojnë lehtë.
- 45. Të fundit në sirtar.



Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

SUDOKU

9	5		8					4
			7	5				8 3
4			1		9			6
		2	9	7		3	5	
8		3				1		9
		5		3	8	7		
	8		4		7			2
3	6			8	2	4		
7					6		9	5

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

9	3	5	4	2	1	7	6	8
6	7	4	8	3	9	1	5	2
2	8	1	6	5	7	3	4	9
1	2	7	5	6	4	9	8	3
3	4	8	7	9	2	6	1	5
5	6	9	1	8	3	2	7	4
7	5	3	9	4	6	8	2	1
8	9	6	2	1	5	4	3	7
4	1	2	3	7	8	5	9	6


Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Argëtim filozofik

- Bota është plot dyer, plot raste, fije të tendosura që presin t'u biesh.
(Ralf Valdo Emerson)
- Të jesh gjithmonë i ndershëm me veten, është një ushtrim i këndshëm.
(Sigmund Frojd)
- Vlera e një njeriu duhet parë në faktin se çfarë jep, dhe jo në atë se çfarë është në gjendje të marrë.
(Albert Anjstajni)

KRIPTOSKEME

KRIPTOSKEME
Përgjigja e numrit të djeshëm



FJALËKRYQI (1)



FJALËKRYQI (2)

Thënie të mënçura

- Sekretit për të mbetur gjithmonë i ri është të jetosh sinçerisht,
- të hash ngadalë,
- dhe të gënjesh reth moshës.
- Mos ndiq vetem rrugët e shtruara. Shko në një rrugë të pashkelur dhe ler një gjurmë pas.
- S'ka gjë më të tmerrshme se sa të shikosh injorancën në veprim.
- Tre janë metodat nga marrim dije: e para, nga reflektimi që është më fisnikja; e dyta, nga imitimi që është më e thjeshta dhe e treta nga eksperiencia, që është më e hidhura.

Lusille Ball

Muriel Strade

(Konfuci)

Filluan regjistrimet

për konkurim në

Kolegjet Turgut Ozal dhe Gulistan



Një fillim i mbarë për një të ardhme të sigurtë...

25 vjet *eksperiencë*
në fushën e arsimit...

Provimi i pranimit për vitin arsimor 2018-2019 do të organizohet në pjesën më të madhe të qyteteve më 21 Prill 2018, në orën 10:00 (për nxënësit e klasës së 8 dhe 9). Hyrja në provim është pa pagesë.



www.turgutozal.edu.al

Për informacion kontakti:
Drejtoria e Përgjithshme
Kolegji "Turgut Ozal" Tiranë
Kolegji "Turgut Ozal" Durrës
Memorial International School of Tirana

Tel: 04 223 47 16
Tel: 04 24 86 538
Tel: 069 74 99 292
Tel: 04 223 73 79



www.gulistan.edu.al

Për informacion kontakti:

Kolegji i vajzave "Mehmet Akif" Tiranë
Kolegji i djemve "Mehmet Akif" Tiranë
Kolegji "Hasan Riza Pasha" Shkodër

Tel: 04 223 48 95 / 069 72 24 082
Tel: 067 300 34 60
Tel: 067 36 50 800 / 067 46 33 300